

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7662 E mërkurë 26 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"

Nga IVICA PETROVIC



Pse e bojkotoi Vuçiç Asamblenë e OKB-së?

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç ka vendosur që të fillojë një fazë të re në raportet me bashkësinë ndërkombëtare, që mund të quhet edhe si bojkotim ...  
Vijon në faqen 20

Opinion i Ditës

Nga SPARTAK NGJELA



PËrjetja që duhet të ngrihet këtu është kjo: pas konsolidimit të pavarësisë së Kosovës dhe krijimit të federatës shqiptaro-bullgare në Maqedoni, e cila ...  
Vijon në faqen 21

Gjenocidi grek në Çamëri, vepër më e rëndë se Holokausti



Përplasja për koncesionet e qeverisë "Antimafia", Basha: Po mbron oligarkët. Rama: Platforma e PD, dhunë biznesit

Kryeministri: Ka marrë fund si parti. Kreu i PD: Shpifje nga mercenarët e pushtetit

VALENTINA MADANI

Kreu i opozitës, Lulzim Basha akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se ka angazhuar mercenarët për të mbrojtur pushtetin dhe paratë e padronëve e të klientëve. Ndërsa për kryeministrin Edi Rama, me sulmet ndaj ...  
Në faqen 3

LISTA E STUDENTEVE TE EKONOMIKU, SHKENCAT SOCIALE DHE ATO TE NATYRES

## UNIVERSITETI I TIRANES, JA FITUESIT E RAUNDIT TE DYTE

Plotësohen vendet edhe në Universitetin e Mjekësisë. 26 fitues në Fakultetin Juridik. Regjistrimet në 27-28 shtator, shans edhe në raundin e tretë



(Në foto) Studentë

AMBICIA NE OKB

Meta dhe Bushati në SHBA, Shqipëria kërkon një vend në Këshillin e Sigurimit

Në faqen 2

PROJEKTI

Rama premtion rritje të pagave në arsim, shëndetësi dhe ushtri në 2019

Në faqen 2

SHFUQIZOHET MASA

Ndryshimi i vendbanimit, hiqet gjoba për mosdeklarimin

Në faqen 5

NGA LUAN RAMA

Henry Miller, nga bota e prostitutave të lëndimi i shpirtit

Në faqen 18-19

VLORE, 1 NE PRANGA



Rikthehen maskat, grabitet me armë furgoni i sapoardhur nga Italia

Në faqen 7

Akuza për korrupsion, arrestohet edhe punonjësjë e ZRPP-së, Frida Mirashi

## Shkodër, pranga në zyrë drejtorit të Hipotekës

Zamir Leka u emërua në janar. Dyshimi, merrte rryshfet për regjistrimet

NGA SENAD NIKSHIQI

SHKODER-Zamir Leka, drejtor i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Shkodër është arrestuar dje nga policia pas një urdhri të prokurorisë dhe pasi gjykata e këtij rrethi kishte pranuar kërkesën për masën e sigurisë



"Arrest me burg". Mësohet se krye regjistruesi akuzohet për veprën penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrjnë funksione publike". Në vendimin e gjykatës për vendosjen e masës së arrestit thuhet se Leka ka pranuar të marrë para nga ...  
Në faqen 8

# VENDIMI I QEVERISË DISKUTIMET

Kryeministri: Ulje taksash dhe rritje pagash, një reformë e re sociale

Darina Tanushi

Qeveria është duke diskutuar rritje pagash për disa kategori punonjësish të shtetit për vitin 2019. Bëhet fjalë për arsimtarët, punonjësit e shëndetësisë dhe ushtarakët. Lajmi u bë i ditur nga vetë kreu i qeverisë, Edi Rama. "Diskutime të frytshme për buxhetin 2019. Ulje taksash. Rritje pagash në arsim, shëndetësi, ushtri. Dhe një risi shumë domethënëse: një politikë e re sociale, që as mendohej dot pa ndërmarrë reformat e dhimbshme shtetbërëse", shkroi dje Rama në rrjetin social "Twitter". Ndërkohë pritet që sot në orën 10:30 të sqarohet më shumë për këtë vendim të qeverisë. Po dje, kryeministri ishte në Nivicë, në kuadër të projektit "100 fshatrat". Gjatë fjalës së tij, Rama theksoi se ky projekt ka ngjallur shumë interes dhe sipas tij, emigrantët po e shohin si mundësi investimi në vendlindjet e tyre. "Më vjen mirë që projekti ka ngjallur shumë interes. Emigrantët po shohin mundësi investimi në vendet e tyre. Jemi të bindur se do të krijojmë një pikë të fortë për zhvillimin rural", tha Rama. "Vijmë këtu në Nivicë, pasi e kemi hedhur një hap të parë, të rëndësishëm, së bashku me Tërmetin në Bashkinë e Tepelenës, hapin e rijetëzimit përmes rilindjes urbane të kësaj qendre të vogël, prej ku do të shtrohet zhvillimi në disa rreze rreth e rrotull, duke u mbështetur te potenciali e zonës. Ky takim është në të njëjtën kohë një forum për të diskutuar konkretisht, por njëkohësisht edhe për të krijuar një qendër gravitimi në vëmendjen e atyre që janë të interesuar të investojnë në këtë zonë, por edhe në të tjera pika të hartës së "100 fshatrave". 100 fshatra janë përcaktuar si pika gravitimi për një zhvillim të qëndrueshëm dhe një zhvillim ndryshe të hapësirës rurale në Shqipëri", u shpreh Rama. Kreu i qeverisë ka qenë i shoqëruar edhe nga ambasadori i Suedisë, por edhe ambasadori i Austrisë dhe ai i republikës çeke, të cilët shkuan në Nivicë, sipas Ramës për të dëshmuar interesin e tyre në funksion edhe të një programi binjakëzimi që qeveria shqiptare ka me vendet e tjera të përfshira. "Tanimë, ne kemi bërë pjesë të paketës së re fiskale, qoftë uljen e TVSH-së në 6% për agroturizmin, qoftë uljen e taksës së fitimit në vetëm 5% nga 15% që ishte, qoftë zërimin e taksës së infrastrukturës dhe në të njëjtën kohë, edhe uljen në vetëm 5% të taksës së fitimit për Shoqëritë e Bashkuara Bujqësore, që ne shpresojmë ta shoqërojmë këtë proces transformimi të 100 fshatrave", tha Rama.

## Qeveria, rritje pagash për arsimin, shëndetësinë dhe ushtrinë në 2019-ën

"100 fshatrat", emigrantët të investojnë në vendlindje



Kryeministri Edi Rama, dje në Nivicë

### DEKLARATA

"Tanimë ne kemi bërë pjesë të paketës së re fiskale, qoftë uljen e TVSH-së në 6% për agroturizmin, qoftë uljen e taksës së fitimit në vetëm 5% nga 15% që ishte, qoftë zërimin e taksës së infrastrukturës dhe në të njëjtën kohë, edhe uljen në vetëm 5% të taksës së fitimit për Shoqëritë e Bashkuara Bujqësore, që ne shpresojmë ta shoqërojmë këtë proces transformimi të 100 fshatrave", tha Rama.

Gjatë një seance parlamentare



### Presidenti Meta e ministri i Jashtëm, bashkë në OKB

## Bushati: Shqipëria, fushatë për të marrë vend jo permanent në Këshillin e Sigurimit

Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara nisi punimet e sesionit të 73-të, ku tema e këtij viti është "Ti vëmë Kombet e Bashkuara në shërbim të popujve, udhëheqje globale dhe ndarje përgjegjësisë për shoqëri paqësore, të barabarta dhe të qëndrueshme". Ministri Bushati në një komunikim për mediat u shpreh se takimi mbahet në një moment shumë të rëndësishëm kur multilateralizimi dhe bashkëpunimi anëmbanë botës janë vënë si rrallëherë në pikëpyetje. Kësajsoj kërkohet që Organizata e Kombeve të Bashkuara jo vetëm të jetë më e pranishme në



zonat e konfliktit, por edhe të garantojë zbatimin e programeve zhvillimore që zbusin hendeqet mes rajoneve të caktuara të globit. Në takimet dypalëshe ministri Bushati, përveç çështjeve që i përkasin agjendës së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera, do të kërkojë edhe mbështetjen e këtyre vendeve për kandidaturën e vendit tonë për

vend jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit. "Shqipëria vjen me ambicien e saj në këto punime, pasi po kërkon një vend jopermanent për në Këshillin e Sigurimit për periudhën 2022-2023 dhe fushata jonë e komunikimit me partnerët e vende të cilat e njohin Shqipërinë apo që dinë pak rreth Shqipërisë sapa ka filluar, me qëllim që të përbushim këtë objektivi politik sonë të jashtëm", nënvizoi ministri Bushati. Edhe Presidenti Ilir Meta mori pjesë në sesionin e 73 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Përmes një postimi në "Facebook", Meta tha se Shqipëria është e përkushtuar ndaj paqes.

shpresojmë ta shoqërojmë këtë proces transformimi të "100 fshatrave". Është ngritur edhe funksionon Akademia e 100 fshatrave, që ka mobilizuar grupe në terren", u shpreh Rama. Në mbërmje kryeministri njoftoi se kompania britanike "Thomas

Cook", e njohur për ofrimin e shërbimeve në destinacionet më atraktive turistike, do të jetë prezente edhe në Shqipëri duke filluar nga pranvera e ardhshme. Në ceremoninë e prezantimit të shërbimeve, Rama u shpreh: "Shpresoj që së shpejti të

nisim aeroportin e Vlorës, çka do t'ju bëjë më të lehtë të sillni vizitorë në jug. Po ashtu, duam të ndërtojmë edhe aeroportin e Sarandës dhe ne jemi shumë të lumtur nëse ju do të keni interes të merrni pjesë në këtë përpjekje".

### KOMISIONI



Deputeti i PS, i pakënaqur me organet e vetingut: Po merren me paratë, jo aftësitë

Komisioni i Ligjeve miratoi dje një shtesë prej 24 personash staf për tri organet e vetingut, me një kosto në buxhet rreth 50 milionë lekë. Tri organet kishin kërkuar 36 persona më shumë në strukturat e tyre. Në mbledhjen e zhvilluar dje pa praninë e opozitës, kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja kërkoi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të veprojë me shpejtësi për ata gjyqtarë e prokurorë që kanë ankimuar shkarkimet nga shkalla e parë e vetingut, në mënyrë që të përshpejtohet ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor e atij të Prokurorisë. Deputeti i PS-së, Alket Hyseni u shpreh i pakënaqur me punën e organeve të vetingut. "Po i merrni vendimet vetëm mbi një komponent. Po i ikën sharmi vetingut. Ka plot gjyqtarë e prokurorë të paaftë. Ju merreni vetëm me ca para", u shpreh Hyseni.

### MINISTRI



Xhafaj pret ambasadorin e ri të BE: Në javët në vijim do kemi rezultate konkrete

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj priti dje në një takim pune ambasadorin e ri të Bashkimit Europian, Luigi Soreca. Përmes një statusi në rrjetin social "Twitter", ministri Xhafaj shkruan se në takim janë shkëmbyer mendime të ndryshme në fushën e zbatimit të ligjit dhe aspiratave të Shqipërisë drejt BE. "Sot pata kënaqësinë të zhvilloja takim shumë miqësor dhe profesional me një ekspert shumë të mirë të çështjeve të sigurisë, me ambasadorin e ri të BE, Luigi Soreca. Trajtuan çështje të rëndësishme mbi prioritetet dhe pritshmëritë e BE e vendeve anëtare ndaj Shqipërisë në fushën e ligjzbatimit. Ambasadori më konfirmoi gatishmërinë për mbështetje e thellim të bashkëpunimit në fushat prioritare të MB e PSH dhe një mbështetje aktive me programet e asistencës financiare dhe teknike për to. Në javët në vijim do flasim për projekte dhe rezultate konkrete. Punë të mbarë z. ambasador!", shkroi Xhafaj.



**EDI RAMA**

"Kur një parti politike shpall si platformë dhunën verbale mbi sipërmarrësit ka ngatërruar sistemin ku veprojmë, ka harruar arsyen pse ekziston, ka marrë fund si alternativë qeverisëse dhe është kthyer në maskë gjobëvënese! Kur këtë parti pastaj e drejton L.B., ferra e ka marrë fare uratën", shprehet z.Rama.



**"Ndryshimi mes sipërmarrësit dhe oligarkut"**

**Platforma për ekonominë, Shehaj: Kush ka vjedhur, nuk do i gëzojë dot**

Deputeti i PD, Agron Shehaj deklaroi dje se platforma e demokratëve për çlirimin e ekonomisë do prekë të gjithë ata biznesmenë apo zyrtarë që kanë vjedhur fondet publike, pavarësisht se kur ka ndodhur. "Lulzim Basha ka propozuar një platformë për çlirimin e ekonomisë, e cila prek të gjitha qeveritë, madje në listë është përfshirë edhe një koncesion i dhënë gjatë qeverisjes së PD-së. Fakti që ka pasur apo jo përpara nuk do të thotë asgjë, sepse do verifikohen të gjitha. Është e rëndësishme që të mos kërkohet justifikimi i vjedhjeve të tanishme, me të gjitha, edhe me trafikun e drogës, me argumentin që dëgjojmë që është qesharak kur thuhet se çfarë problemi ka krimi në Shqipëri, apo lidhja e krimit me politikën kur këto kanë ndodhur gjithmonë. Ky nuk është argument. Nëse një kompani krijohet 2 ditë para dhe më pas merr koncesion, këtu kemi të bëjmë me një fakt. Nëse Vilma Nushi merr një koncesion prej 70 milionë eurosh në një fushë ku nuk ka asnjë eksperiencë, kur duhet se ka qenë mbështetëse e PS, nuk ke nevojë ta provosh. Një koncesion pa asnjë vlerë, që është marrë pa asnjë lloj gare", tha Shehaj në "Top Channel". Sipas deputetit të PD, sot vendi qeverisës keq dhe kjo shihet nga dëshira e madhe e shqiptarëve që duan të ikin nga Shqipëria. "Duhet të gjykojmë se si ishte vendi kur Rama erdhi në pushtet dhe të shohim se si është Shqipëria sot. Të gjithë treguesit janë përkeqësuar. Marrim rastin e dëshirës së shqiptarëve për të ikur nga vendit, si treguesin kryesor të qeverisjes. Në 2013-ën kishte 140 mijë shqiptarë që aplikonin lotarinë amerikane, ndërsa vitin e kaluar ishin 400 mijë. Ky është një fakt. Nëse një ministër që ka rrogën 2 milionë lekë, s'ka të ardhura të tjera e del me një makinë 200 mijë euro, unë nuk kam nevojë ta provoj, më mjafton dyshimi. Ai është i korruptuar. Unë kështu mendoj", tha Shehaj.

**TAULANT BALLA**  
"Opozita është gardiani i qeverisjes, por sot në Shqipëri, kryetari i PD, Lulzim Basha është një gjobëvënës i rëndomtë i sipërmarrjes. 11 milionë dollarë gjobë/fatura kanë paguar te kunati i Bashës kompanitë e 'oligarkëve'", tha kreu i deputetëve të PS-së.

Përplasja, kryeministri: PD ka marrë fund si alternativë qeverisëse

# "Antimafia", Basha: Po mbron oligarkët. Rama: Je si ferrë

## Kreu i PD: Mercenarët përbaltin si padroni

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se ka angazhuar mercenarët për të mbrojtur pushtetin dhe paratë e padronëve e të klientëve. Ndërsa për kryeministrin Edi Rama, me sulmet ndaj sipërmarrjes, Partia Demokratike mori fund si alternativë qeverisëse dhe u kthye në parti gjobëvënese. Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, iu përgjigj akuzave të mazhorancës, duke theksuar se propaganda e qeverisë i ndezi motorët me përbaltje nga mercenarët e Ramës për të mbrojtur pushtetin dhe paratë. Z.Basha përmes një statusi në "Twitter" hodhi akuzë në drejtim të kryeministrit Edi Rama. Basha shprehet se kryeministri ka ndezur motorët e propagandës me shpifje dhe përbaltje për të mbrojtur pushtetin dhe se hendeku midis oborrit të Ramës dhe njerëzve të thjeshtë do të thellohet. "Propaganda e Ramës i ka ndezur të gjithë motorët. Shpifje e përbaltje për të mbrojtur pushtetin dhe paratë nga të gjithë shërbëtorët e mercenarët e padronit dhe klientëve të tij. Hendeku midis oborrit të Ramës dhe njerëzve të thjeshtë do të thellohet. Unë jam në anën e njerëzve!", shkruan Basha. Reagimi i Kryetarit të PD-së, Lulzim Basha erdhi ndaj deklaratës së deputetës së PS, Klotilda Ferhati, e cila tha se kunati i kreut demokrat zotëron 6 kompani reklamash dhe konsulence. Basha e cilësoi këtë deklaratë si propagandë të Ramës për të mbrojtur pushtetin dhe paratë e padronit dhe klientëve të tij. Por, vetëm pak minuta nga reagimi i Bashës në "Twitter", në të njëjtën mënyrë i është kundërpërgjigjur kryeministri Rama në të njëjtin rrjet social, duke shkruar se PD ka harruar arsyen pse ekziston. Rama shkruan se PD-ja ka marrë fund si alternativë qeverisëse e është kthyer në maskë gjobëvënese. "Kur një parti politike shpall si platformë dhunën verbale mbi sipërmarrësit ka ngatërruar sistemin ku veprojmë, ka harruar arsyen pse ekziston, ka marrë fund si alternativë qeverisëse e është kthyer në maskë gjobëvënese! Kur këtë parti pastaj e drejton L.B., ferra e ka marrë fare uratën", mbyllet reagimi i Ramës. Mazhoranca dhe



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

**LULZIM BASHA**

"Propaganda e Ramës i ka ndezur të gjithë motorët. Shpifje e përbaltje nga shërbëtorët e mercenarët e Ramës për të mbrojtur pushtetin dhe paratë e padronit dhe klientëve të tij. Hendeku midis oborrit të Ramës dhe njerëzve të thjeshtë do të thellohet. Unë jam në anën e njerëzve!", theksoi z.Basha.

**Platforma për anulimin e koncesioneve**

## Gjijnuri: PD, gjobëvënie ndaj biznesit, por mbrohen me konventa

Kreu i opozitës, Lulzim Basha paralajmëroi dy ditë më parë se kur të vijë në pushtet, të gjitha projektet me Partneritet Publik-Privat do të konfiskohen. Por, mazhoranca e cilësoi dje planin e PD-së për anulimin e koncesioneve një kërcënim për zhvillimin ekonomik. Sipas ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjijnuri, deklaratat e opozitës janë gjobëvënie dhe kërcënim për zhvillimin ekonomik të këtij vendi. Kreu i Infrastrukturës theksoi se qeveria do të vijojë projektet e saj për zhvillimin e vendit. "Nuk e mendoj nivelin e degradimit deri në situata prapapollitike, të një partie kryesore opozitare, që pretendon të vijë në pushtet, sepse dek-



larata të tilla, më e pakta janë gjobëvënie, ndërsa më shumë janë të kërcënosh zhvillimin ekonomik të këtij vendi. Shqipëria është anëtare e konventave ndërkombëtare, që mbrojnë çdo lloj investimi dhe ka ikur koha kur një parti politike, që për interesat e saj politike të kërcënojë

**Ervin Saliانji**

"Klotilda Bushka po përpiqet të fshehtë pasurinë e bashkëshortit, Altin Bushka. Bashkëshorti ka 10-fishuar të ardhurat e kompanisë, që me ardhjen në pushtet të Ramës. Në katër vitet e fundit, kompania ka 10-fishuar pasurinë. Kjo është vetëm pasuria e dukshme", tha Saliانji.

biznese të cilat investojnë në këtë vend, apo të ndërmarrë masa, të cilat janë të denja për regjime që i ka ikur koha. Kështu që unë e quaj thjesht manifestimi i degradimit politik të PD në një nivel parapollitik dëshpërues", deklaroi z.Gjijnuri.

larë. Deputetja e Partisë Socialiste, Klodida Bushka Ferhati, në një deklaratë për mediat ka sulmuar kreun e PD, Lulzim Basha. Në deklaratën për shtyp, Ferhati shprehet: "Kunati i tij, Erion Isufi zotëron jo

një, por plot gjashtë kompani reklame dhe konsulence Landmark Communicatins', Landmark Technologies', Landmark Premium Print', 'HR Solutions', 'Albania Internet' dhe 'Blacksheep'.

**Shoqëria përmbartore JUSTITIA**

shpall ankandin, faza DYTE, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna: Tërfaqsi Ndërtëse me sipërfaqe 250 m<sup>2</sup>, nga ku truall 250 m<sup>2</sup>, dhe ndërtëse 101 m<sup>2</sup>, nr. pasurie 9/383, Vol. 161 fq. 101, zona kadastrale 6532 me adresë L. 'Sheq i Madh' Fier, e regjistruar në emër të Enver Demir Buzi. Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është **3.640.000** (tre milion e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë. Ankandi zhvillohet në datën 25.10.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartës gjyqësor me adresë Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web-[www.studiojustitia.com](http://www.studiojustitia.com), tel. +355 4 2270890

## TEATRI KOMBETAR DEKRETI

Kreu i shtetit, 20 ditë afat për t'u shprehur për ligjin e amenduar të Teatrit Kombëtar

Valentina Madani

Ligji për Teatrin Kombëtar, i miratuar vetëm me votat e mazhorancës djembërriti në Presidencë. Ligji i amenduar për ndërtimin e Teatrit të ri tashmë është në tavolinën e punës së presidentit, ndërkohë që z. Meta ndodhet në SHBA, ku po merr pjesë në Asambledën e Përgjithshme të OKB-së. Stafii i Presidentit Ilir Meta mori në shqyrtim dokumentet e përcjella nga Kuvendi, ndërsa vendimi nga presidenti për dekretim ose jo do të jetë brenda 20 ditësh pas kthimit të Metës nga OKB-ja. Ligji mban të njëjtin numër me të variantit të parë, 37, datë 20.09.2018, ndërsa Kuvendi ia dërgon kreu të shtetit për shpallje dhe dëni. Pikërisht këtu lindi edhe debati mes shumicës dhe opozitës. Ky debat mund të sheshohet vetëm me interpretimin apo veprimin e kreu të shtetit. Pasi Meta e riktheu për shqyrtim, opozita e amendoi ligjin dhe miratoi në Kuvend variantin e ri, që pikë kryesore kishte hapjen e garës edhe për kompani të tjera, përveç "Pushës". Opozita u pozicionua kundër duke deklaruar se me votimin pro të dekretit të Metës, ligji ra dhe nuk mund të bëhen amendime. Sipas PD-së dhe LSI-së, shumica ndryshimet mund t'i bënte vetëm përmes një ligji të ri, që duhet të kalojë të gjitha procedurat. Opozita shprehet se me procedurën që u veprua nga shumica, presidenti i hiqet e drejta për të rikthyer sërish ligjin. PS e konsideron ligj të njëjtë, se mban të njëjtin numër me të vjetrin. Mësohet se duke qenë që nuk është i njëjti ligj, kreu të shtetit i lind e drejta ta pranojë apo kthejë atë, ose ta kalojë në heshtje. Burimet thonë se ligji që ka shkuar në Presidencë është një ligj i ri dhe si i tillë do trajtohet, çka do të thotë që presidenti do të marrë kohën e duhur për t'u shprehur për atë me dekret ose jo. Por, i pyetur nga "Ora News", kreu i komisionit përgjegjës, deputeti socialist Eduard Shalsi është shprehur se ligji që është dërguar kreu të shtetit nga parlamenti është i njëjti dhe se atij i ndryshon vetëm data. Si i tillë, shumica pretendon që kreu i shtetit të mos e kthejë ligjin në bazë të nenit 85 të Kushtetutës, i cili thotë që Presidenti ka të drejtë ta kthejë ligjin për shqyrtim vetëm një herë. Por juristë të opozitës, e cila është kundër prishjes së Teatrit Kombëtar shprehen se me pranimin e dekretit, ligji ka rënë dhe shumica ka miratuar një ligj

# 'Teatri' rishkon në Presidencë, PS-PD përplasen për firmën e Metës

Opozita: Amendimet që iu bënë konsiderohen ligj i ri



Presidenca

të ri, që për PD është anti-kushtetues për shkak të procedurës që shumica ndoqi dhe si i tillë duhet rrëzuar. Në rastet kur dekretet pranohen siç ndodhi për Ligjin për Teatrin, demokratët shprehen se ligji në fjalë bëhet nul.

Ata thonë se me amendimet që iu bënë konsiderohet një ligj i ri, çka sipas Kushtetutës, i jep të drejtën presidentit ta kthejë sërish në Kuvend për shqyrtim. Sipas ligjit, kreu i shtetit ka 20 ditë afat për shpalljen e ligjit dhe

ky afat përfundon në 13 tetor. Deri atëherë duket se debati do të vazhdojë nëse kreu i shtetit ka të drejtë ta shqyrtojë në themel, ku përfshihet edhe kthimi për shqyrtim, apo thjesht duhet ta kalojë atë në heshtje.

### LIGJI

Kushtetuta thotë se vendimi për dekretim ose jo bëhet brenda 20 ditësh. PD e konsideron të ri ligjin dhe i jep Presidentit të Republikës të drejtën e rikthimit të tij. Stafii juridik i presidentit ka nisur shqyrtimin e dokumenteve të përcjella nga Kuvendi. PS e konsideron ligj të njëjtë, pasi mban të njëjtin numër me të vjetrin.

### "Prokuroria të hetojë ministrin për fshehje provash"

Noka: Komplot për mbylljen e çështjes së vëllait të Xhafajt

Partia Demokratike iu referua një deklaratë të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, në një intervistë televizive për ta akuzuar se bashkë me kryeministrin është përfshirë në një komplot shtetëror për të mbyllur me metoda mafioze skandalin e të vëllait trafikant të dënuar në Itali. "Është tjetër gjë të provosh është apo s'është (i vërtetë përgjimi) dhe tjetër gjë të provosh kush dhe përse e ka bërë këtë gjë. Dhe unë kam provat e mia. Kam faktet e mia, padyshim", deklaroi ministri Xhafaj. Por, PD përmes z. Flamur Noka akuzoi: "Fatmir Xhafaj dhe Edi Rama janë drejtpërdrejt të përfshirë në një komplot shtetëror për të mbyllur me metoda mafioze skandalin e të vëllait trafikant droge të ministrit të Brendshëm. Njëllaj si Edi Rama, edhe Fatmir Xhafaj deklaroi se përgjimi i të vëllait është i sajuar dhe për këtë ai disponon prova". Deputeti demokrat, Flamur Noka tha se në një shtet normal ku mbrohet interesi publik dhe jo interesi i pushtetit të lidhur me krimin, prokuroria duhet të kishte hetuar Edi Ramën dhe Fatmir Xhafajin për fshehje të provave dhe pengim të drejtësisë. "Është e qartë se deklarata të tilla janë pjesë e skenarit mafioz për t'i imponuar prokurorisë një rezultat hetimor të paracaktuar. Me veprime të tilla kriminale, Fatmir Xhafaj dhe Edi Rama kanë kryer veprën penale të pengimit të drejtësisë dhe manipulimit të së vërtetës. Nëse ka prova, ministri i Brendshëm duhet t'i kishte çuar në prokurori. Njëllaj duhet të kishte vepruar edhe Edi Rama, kur deklaroi se dispononte përgjigjet e një laboratorit imagjinar shkencor për vërtetësinë e audio-përgjimit të vëllait trafikant droge të ministrit të



### AKUZA

"Në një shtet normal, ku mbrohet interesi publik dhe jo interesi i pushtetit të lidhur me krimin, prokuroria duhet ta kishte hetuar Edi Ramën dhe Fatmir Xhafajin, më së paku për fshehje të provave dhe pengim të drejtësisë", tha z.Noka.

### Berisha: "Kampion Europe" për azilkerkuesit

Paralajmërimi i Gjoshës: Azilkerkuesit mund të rikthehen në bombë

Ish-kryeministri Sali Berisha pas publikimit të një raportit nga EUROSTAT lidhur me kërkesat për azilkerkuesit, ka sulmuar qeverinë "Rama". Berisha thekson se nuk lëviz nga vendi i parë, ndërsa me ironi shton se është "kampion Europe" për azilkerkuesit. Po ashtu, ai theksoi se ky është 'suksesi' i kësaj qeverie për hapjen e negociatave. "Shqipëria nuk lëviz nga vendi i parë, 'kampion Europe' për azilkerkuesit! Ky është suksesi i Kallam Dëshatakut dhe progresi i Shqipërisë drejt hapjes së negociatave!", shprehet z.Berisha. Edhe ish-ministria e Integritimit, Klajda Gjoshja, deklaroi se çështja e azilkerkuesve mund të kthehet sërish në bombën e madhe të perspektivës së vendit tonë drejt integritimit evropian. "Azilkerkuesit mund të kthehen sërish në



bombën e madhe të perspektivës sonë evropiane dhe të lëvizjes sonë të lirë! Në një raport mbi azilkerkuesit për herë të parë në vendet e BE, Shqipëria renditet përsëri krahas vendeve me numër të lartë të njerëzve që largohen nga vendi. Ndryshimi i vetëm dhe absurd është fakti që vendi ynë nuk është as në gjendje lufte dhe as një vend jashtë

**PETRIT VASILJ**  
"Shqiptarët kanë numrin më të lartë të azilkerkuesve në Europë. Kjo është mënyra e kryeministrit të vetëm dhe armik të të gjithëve. Fshati shqiptar në skamje, më keq se të gjitha vendet e Ballkanit dhe e thotë Banka Botërore. Kjo është fatkeqësia që vjen prej kryeministrit të vetëm dhe armik të të gjithëve".

kufijve të Evropës. Ky numër i lartë edhe gjatë muajve të fundit të 2018-ës është një tregues i gjendjes së rëndë ku ndodhet vendi ekonomikisht. Çështja është se në muajt që vijnë ky fenomen do të kthehet në bllokues të negociatave dhe të perspektivës evropiane të Shqipërisë", shprehet zj.Gjoshja.

**Përkeqësohet liria ekonomike**

**Shqipëria humbet 2 pozicione në indeksin global**

Shqipëria ka humbur 2 pozicione në indeksin global të lirisë ekonomike, të publikuar çdo vit nga instituti prestigjioz "Fraser", ndër më të specializuarit në nivel global për lirinë ekonomike. Këtë vit Shqipëria renditet e 34-ta, ndër 162 vende të botës, nga vendi i 32-të i vitit të kaluar. Pavarësisht rënies në renditje, vendi ynë rajon të mbetet i pari në rajon në këtë drejtim. Të

dhënat në raport i referohen vitit 2016. Pikëzimi ndërkohë është i njëjtë me atë të raportit të kaluar, çka do të thotë se Shqipëria ka humbur vende vetëm si pasojë e përmirësimit më të madh të sheteve të tjera. Indeksi i përgjithshëm përlogarit mbi bazën e 5 kritereve, ai që shënon performancën më të mirë është nën-indikator i qëndrueshmërisë së parasë. Monedha



vendëse duket se është e mbrojtur nga rreziqet e jashtme dhe ato të brendshme çka është në favor të një lirie më të madhe ekonomike. Nënindikator i me performancën më të dobët ndërkohë, është ai i sistemit ligjor dhe të drejtës së pronës. Në këtë drejtim, Shqipëria lë shumë për të dëshiruar.

**Dy versionet që po diskuton qeveria**

**Paketa e re fiskale, ulet tatimi për dividentin**

Paketa e re fiskale pritet të sjellë ndryshime të rëndësishme taksash, duke filluar që nga 1 janari i vitit të ardhshëm. Në draftin që po diskutohet në qeveri, ndryshimi kryesor është ulja e tatimit mbi dividentin. Aktualisht, norma e tatimit mbi dividentin është 15 për qind. Propozimi i qeverisë në paketën e re fiskale është që kjo tak-

të ulët. Qeveria aktualisht po shqyrtohen dy variante. I pari është ai që tatimi mbi dividentin të zbrësë në 8 për qind, ndërsa varianti i dytë parashikon uljen e kësaj takse në shkallën 10 për qind. Varianti final pritet të zyrtarizohet nga vetë kryeministri gjatë ditëve në vijim, kur paketa të bëhet publike. Ulja e tatimit mbi dividentin lehtëson barrën e taksave, kryesisht për bi-

zneset e mëdha. Por, qeveria e cilëson atë si një masë kompensuese, që pason uljen e taksave për biznesin e vogël, e cila u votua pak kohë më parë. Përmes një pakete të miratuar në mes të këtij viti, por që hyn në fuqi nga 1 janari i vitit të ardhshëm, qeveria e uli me tri herë tatimfitimin për bizneset e vogla dhe të mesme me xhiro vjetore nga 8 deri në 14 milionë lekë në vit. Për këto biznese, shkalla e tatimfitimit është 15 për qind. Por, sipas paketës së miratuar në mes të vitit, nga 1 janari i vitit të ardhshëm, ai do të ulet në 5 për qind, një masë nga e cila sipas qeverisë përfitojnë mbi 10 mijë biznese të vogla dhe të mesme.

Shfuqizohet masa administrative, ndryshim banese brenda 6 muajve

Ornela Manjani

**Ndryshimi i vendbanimit, hiqet gjoba 10 mijë lekë për mosdeklarim**

*Projektligji/ Masa ligjore nuk dha asnjë efekt*

Qeveria heq dorë nga gjoba 10 mijë lekë për mosdeklarimin e ndryshimit të vendbanimit. Qytetarët që ndryshojnë banesë dhe nuk e deklarojnë atë, do t'i shpëtojnë gjobës për 6 muaj. Heqja e masës administrative është përcaktuar në një projektligj të ri të dërguar në Kuvend, ku parashikohet ndryshimi i masës së gjobës për banorët që ndryshojnë banesë dhe nuk e deklarojnë brenda 6 muajve. Sipas draftit në nënin 11, thuhet se është parashikuar një dispozitë kalimtare, me qëllim pezullimin e masës së gjobës për një periudhë prej 6 muajsh, e cila aktualisht aplikohet ndaj shtetasve që nuk deklarojnë ndryshimin e vendbanimit brenda afateve ligjore. "Vlera e gjobës, e cila u rrit ndjeshëm me ndryshimet ligjore të ligjit për gjendjen civile, në vitin 2016, nuk solli efektet e pritshme në ndërgjegjësimin e shtetasve për deklarimin e ndryshimit të vendbanimit. Pezullimi për gjashtë muaj i aplikimit të kësaj mase administrative konsiderohet një mundësi, shtysë tjetër për ndërgjegjësimin e atyre shtetasve që nuk kanë deklaruar vendbanimin aktual, përmendim këtu shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk kanë pasur informacionin e duhur për detyrimin ligjor të deklarimit të vendbanimit", thuhet në relacionin që shoqëron projektligjin. Në vitin 2016 u vendos që banorët që ndryshojnë banesën kanë detyrim ligjor deklarimin e tyre pranë gjendjes civile përkatëse, ndryshe masa e gjobës për mosdeklarim do të ishte 10 mijë lekë.



Foto ilustruese

qartësuar detyrimet e punëdhënësit, në rastin konkret të kryetarit të bashkisë dhe prefektit të qarkut, të cilët kanë detyrimin për lidhjen e kontratës së punës

me nëpunësin e shërbimit të gjendjes civile, që emërohet sipas rregullave të përcaktuara nga DPGJC-ja; - administrimin e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, në linjë me

politikat e administrimit të bazave të të dhënave shtetërore; parashikimin në mënyrë të shprehur qartë për ofrimin e shërbimeve nga zyrat e gjendjes civile për

**DEKLARIMI**  
"Vlera e gjobës, e cila u rrit ndjeshëm me ndryshimet ligjore të ligjit për gjendjen civile, në vitin 2016, nuk solli efektet e pritshme në ndërgjegjësimin e shtetasve për deklarimin e ndryshimit të vendbanimit".

ndryshimit të vendbanimit nga shtetasit brenda afateve ligjore.  
**DRAFTI**  
Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar", propozohet me qëllim zgjidhjen e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të tij, siç janë dy prej çështjeve kryesore lidhur me ndryshimin e politikave të ndjekura nga Këshilli i Ministrave për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore si dhe pezullimin për gjashtë muaj të masës administrative që aplikohet ndaj atyre shtetasve që nuk deklarojnë ndryshimin e vendbanimit brenda afateve ligjore.

**Tatimet këshillojnë biznesin e vogël**

**Të dhënat dhe dokumentet që duhet të mbajë çdo subjekt**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka publikuar dje informacionin mbi mënyrën se si një biznes i vogël duhet të ruajë të dhënat dhe të mbajë dokumentet. Personi i tatueshëm, subjekt i Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël dhe i Tatimit mbi të Ardhurat, kur kryen një furnizim mallrash apo shërbimesh, në momentin e furnizimit është i detyruar të lëshojë faturë të thjeshtë tatimore në lidhje me atë furnizim

për çdo person të tatueshëm, që merr furnizimin, përveç rasteve kur në bazë të legjislacionit tatimor në fuqi është personi i tatueshëm i TVSH-së dhe është i detyruar të lëshojë faturë me TVSH. Sipas njoftimit, forma dhe përmbajtja e faturës së thjeshtë tatimore është përcaktuar në ligjin "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar dhe në udhëzimin në zbatim të këtij ligji "Për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël". Për blerësin, person

i tatueshëm, subjekt i çfarëdolloj tatimi, kjo faturë shërben si dokument justifikues për shpenzimet e zbritshme të biznesit. Forma dhe përmbajtja e faturës së thjeshtë tatimore është përcaktuar në ligjin "Për sistemin e taksave vendore" dhe në udhëzimin në zbatim të këtij ligji. Personi i tatueshëm, tatimpagues i Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël është i detyruar të lëshojë faturë të thjeshtë tatimore edhe për çdo furnizim mallrash e shër-



bimesh të kryer për organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, që kryejnë veprimtari të ndryshme. Gjithashtu, personi i tatueshëm shitës me pakicë,

tatimpagues i Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël, për çdo shitje në njësitë e shitjes me pakicë, të kryer për individë konsumatorë finalë është i detyruar të lëshojë kupon tatimor me pajisje fiskale dhe në mungesë të saj, dëftesë tatimore.

4 prokurorët e rinj marrin në duar dosjen

Dështon pretenca për Shullazin, shkak mungesa e avokatit Aldo Tabaku

Dështon seanca gjyqësore ku pritej të jepej pretenca e prokurorisë për Emiljano Shullazin dhe bashkëpunëtorët e tij. Grupi prej katër prokurorësh Gentian Osmani, Besnik Muçi, Anton Martini me në krye Donika Prelën drejtuesen e komanduar të Krimeve të Rënda u ulën mëngjesin e së martës në sallën e gjyqit në gjykatën për Krime të Rënda, në përpjekje për të shpallur pretencën për grupin "Shullazi", por pa mundur t'ia dalë mbanë. Në seancën gjyqësore, e cila nisi me disa minuta vonë, vijoi me mungesa e pesë të pandehurve, Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Blerim Shullazi. Pikërisht ky i fundit, përmes një shkresë drejtuar trupës gjyqësore, e cila nisi me disa minuta vonë, vijoi me mungesa e pesë të pandehurve, Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Blerim Shullazi. Pikërisht ky i fundit, përmes një shkresë drejtuar trupës

KËRKESA

Në seancën gjyqësore, e cila nisi me disa minuta vonë, vijoi me mungesa e pesë të pandehurve, Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Blerim Shullazi. Pikërisht ky i fundit, përmes një shkresë drejtuar trupës gjyqësore kërkonte shtyrje të procesit, me argumentin se donte të ishte personalisht i pranishëm. Edhe avokati i tij, Aldo Tabaku, i cili nuk u paraqit në seancë, kërkoi shtyrje të pretencës për probleme personale.

gjyqësore kërkonte shtyrje të procesit, me argumentin se donte të ishte personalisht i pranishëm. Mospraninë në seancë ai e justifikonte me problemet shëndetësore. Edhe avokati i tij, Aldo Tabaku, i cili

nuk u paraqit në seancë, kërkoi shtyrje të pretencës për probleme personale. Prokurorët e konsideruan të qëllimshme mungesën e në këtë pikë replikuan me avokatët, të cilët i akuzuan për mu-

ngesë humanizmi. Seanca e radhës është vendosur më 2 tetor. Kujtojmë se çështja "Shullazi" shkaktoi një furtunë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe atë të Krimeve të Rënda. Kjo pasi një grup prokurorësh refuzuan hedhjen e shortit në procedimin penal në gjykim në ngarkim të të pandehurve Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Blerim Shullazi, të cilët ndodhen pas hekurave për një sërë akuzash. Ky refuzim çoi në kërkesën për hetim disiplinor ndaj tyre nga ana e



kryeprokurores Arta Marku. Konkretisht Prokurorja e Përgjithshme urdhëroi transferimin e përkohshëm në rrethet e tre nga dhjetë prokurorët që refuzuan hedhjen e shortit për dosjen Shullazi. Bëhet fjalë për prokurorët: Olsian Çela, i cili do të transferohet në Prokurorinë e Beratit, Sonila Muhametaj, e cila do të transferohet në prokurorinë e

Pukës dhe Besim Hajdarmatajn, i cili do të transferohet në prokurorinë e Pogradecit. Gjithashtu, Arta Marku kërkoi që për këta prokurorë, por edhe për shtatë të tjerë të nisë edhe hetimit disiplinor për thyerje të urdhrave të drejtueses së Krimeve të Rënda Donika Prela, e cila dështoi në hedhjen e shortit për dosjen Shullazi.

Denoncimi te ish-kryeministri: Ministri pajisi me pasaportë diplomatike "kokën" e grupit

"Bajri", gjykata lë në burg tre anëtarët e tjerë të bandës

Safet Bajri njihet me masën e tretë të sigurisë për "Armëmbajtje pa leje"

Gjykata e Krimeve të Rënda caktoi ditën e djeshme masën e sigurisë për 3 anëtarët e tjerë të grupit "Bajri". Konkretisht Ismet Idrizi, Denis Brajoviq dhe Klaudio Haxholli, të cilët u arrestuan në kuadër të operacionit "Oaz" do të qëndrojnë në burg. Para të njëjtës gjykatës doli sërish edhe Safet Bajri, ndaj të cilit u dha një masë e re sigurie "arrest me burg". Gjatë së hënës, ai u njoh me dy masa sigurie, një të caktuar nga gjykata e Shkodrës për llogarit të drejtësisë belge dhe një tjetër nga Krimet e Rënda, pas dyshimeve për akuzën e trukumit të ndeshjeve. Akuzat e radhës ndaj tij, është ajo e armëmbajtjes pa leje. Dy ditë më parë u dha vendimi për 6 nga 11 të arrestuarit e këtij grupi, ku u la në masën e sigurisë "arrest me burg", Ilir Rustemi (Bajri), i arrestuar në 6 shtator në Shkodër; Emrah Plaku, i arrestuar në 6 shtator në Shkodër; Astmer Bilali, i arrestuar në 6 shtator në Shkodër; Armir Grimaj, arrestuar në Shkodër; Safet Rustemi (Bajri), i arrestuar në Tiranë dhe Fabilol Rexhepi, i arrestuar në Shkodër. Në përfundim të procesit gjyqësor reagoi avokati mbrojtës i Safet Bajrit, i cili eka cilësuar të paligjshëm vendimin e Krimeve të Rënda duke theksuar se nga pala mbrojtëse u ofrua garancia pasurore, por kjo nuk u mor parasysh. Sipas tij akuzat e vet-



me ndaj klientit të tij është ndikimi në gara sportive. Ndërkohë ish-kryeministri Sali Berisha ka publikuar ditën e djeshme në faqen e tij zyrtare në "Facebook" një mesazh ku pasqyroj një denoncim të ardhur në adresë të tij nga një qytetar. Në denoncimin në fjalë thuhet se ministri i Jashtëm Ditmir Bushati pajisi me pasaportë diplomatike Enver Bajrin, aktualisht në kërkim policor dhe sipas hetuesve drejtuesi i grupit Bajri. "Përsëhendetje Doktor lidhur me bandën Bajri që policia u kujtua t'i arrestojë jo kur kryenin krime, por vetëm kur opozita zbriti në Shkodër dhe arriti t'i tregojë lidhjet e tyre me qeverinë, nga Edi Rama, i cili dërkonte dhe bënte fushatë në lokalitetin e Bahri Bajrit te Ditmir Bushati

dhe Luan Harusha që i mbanin para dhe mbrapa sa herë vinin në Shkodër. Por po të informoj se më kryesori i tyre Enver Bajri shëtit i lirë nëpër botë, sepse është i pajisur me pasaportë diplomatike nga Ditmir Bushati që në qershor të vitit 2014. Përveç kësaj policia me porosi të prerë nga sipër po i çliron nga Krimet e Rënda duke u ngarkuar atyre akuzat qesharake që të dalin sa më shpejtë të lirë", thuhet në mesazhin e publikuar. Kujtojmë se Enver Bajri, i njohur si truri i bandës 'Bajri', që e kishte shtrirë aktivitetin e saj kriminal në disa shtete konsiderohet si një ndër njerëzit më të kërkuar të momentit. 45-vjeçar, mundi t'i shpëronte superaksionit të koduar "Oaz", gjatë të cilit u vunë në pranga 11 të dyshuar

si anëtarë të grupit kriminal, mes tyre dhe krahu i tij i djathtë, Safet Rustemi Bajri. Ai dyshohet se ndodhet jashtë vendit dhe konkretisht në Belgjikë. Sipas burimeve zyrtare hetimet për goditjen e këtij grupi kriminal u bazuan te dhjetëra orë përgjime, mijëra informacione të shkëmbyera me partnerët, u analizuan mijëra faqe të dhëna, si edhe u kryen veprime pro-aktive në terren, përmes kontrollit nga ajri (dron) dhe vëzhgimit intensiv. Oficerë të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me oficerë të kontaktit të vendeve të përfshira në operacion, kanë kryer veprime në terren për evidencimin, lokalizimin dhe ndalimin e shtetasve anëtarë të grupit, që vepronin jashtë Shqipërisë, e kryesisht në Holandë.

BELGET: SAFET BAJRI QENDRON NË SHQIPËRI

Ministri i Drejtësisë belge Koen Geens ka folur rreth operacionit "Oaz". "Nuk kemi marrëveshje ekstradimi me Shqipërinë. Safet Bajri ka mundësi ta vuajë dënimin në Shqipëri. Ka pasur vonesa në dërgimin e dosjes në Shqipëri. Bajri ka 3 dënime në Belgjikë me 9,5 dhe 8 vite burg", tha ministri belge.

Zjarr në një apartament në Tiranë, humb jetën një 60-vjeçar

TIRANË- Një 60-vjeçar ka humbur jetën mëngjesin e djeshëm në kryeqytet, pasi apartamenti ku jetonte u përfshi nga flakët. Sipas të dhënave nga policia zjarri ka rënë rreth 04:40, në rrugën "Ramazan Demneri", në një apartament në katin e tretë. Policia dhe zjarrfikësit kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe kanë bërë evakuimin e menjëhershëm të banorëve, ku dy prej tyre u është dhënë ndihmë mjekësore pasi ishin asfiksuar nga tymi. Zjarrfikësit kanë bërë të mundur shuarjen e zjarrit, por si pasojë e asfiksionit dhe djegies ka ndërruar jetë shtetasia Lulëzim Canaj, rreth 60 vjeç, i cili jetonte i vetëm në banesën ku ra zjarri dhe sipas dëshmitarëve ishte invalid. Burime për "Balkanweb" thanë se 60 vjeçari vuante nga një sëmundje e rëndë dhe si pasojë e mjekimeve kishte pamundësi të lëvizte.

Policia po heton për zbardhjen e shkaqeve të zjarrit, por paraprakisht rënia e zjarrit dyshohet nga shkaqe aksidentale.

"Extra Service", shkatërrohet baza e prostitucionit në Tiranë

TIRANË- Pas një hetimi 7 mujor, policia e Tiranës ka mundur të zbulojë disa baza prostitucioni, të cilat funksiononin në disa qendra estetike në Tiranë. Në kuadër të operacionit të koduar "Extra Service", policia ka goditur disa qendra relaksimi, të cilat dyshoheshin se përdorreshin për prostitucion. Nga ky aksion, janë arrestuar 3 person ndaj të cilëve rëndon akuzat për "shfrytëzim prostitucioni" dhe është shpallur në kërkim një tjetër. Gjithashtu, po procedohen në gjendje të lirë 7 persona. Ndërkohë vijojnë hetimet për zbardhjen e plotë të të gjithë rrjetit. Operacioni i policisë ka marrë emrin "Extra Servis" edhe nga fakti se klientët paguanin një tarifë prej 50 mijë lekësh për të bërë një masazh të thjeshtë dhe nëse kërkoheshin një shërbim ekstra si për shembull, masazh erotik apo favor seksual paguanin shuma nga 100 deri në 200 euro. "Seksioni për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas një pune hetimore 7-mujore, finalizuan operacionin policor të koduar "Extra Service" në kuadër të të cilit u bë arrestimi i shtetasve: H. D., 33 vjeç, banues në Tiranë; A. M., 28 vjeçe, banuese në Tiranë; L. Q., 34 vjeçe, banuese në Tiranë si dhe është shpallur në kërkim shtetasia M.M., 43 vjeç, banues në Tiranë. Ambientet e qendrave të masazhit që administronin, ata i vendosnin në dispozicion për të ushtruar prostitucion, vajzat e punësuar në to. Gjithashtu janë proceduar në gjendje të lirë 7 punonjëse në këto qendra, për ushtrim prostitucioni. Janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale DVR, kamera vëzhguese, aparate celulare dhe 4 ambiente ku ushtrohej ky aktivitet. Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprime të mëtejshme", thuhet në njoftimin e policisë.

Shpallen në kërkim 2 të tjerë. Policia: Autorët, grup i mirorganizuar e jo amatorë

## VLORE

Rikthehen grabitjet në Vlorë. Tre persona të maskuar dhe të armatosur me kallashnikovë kanë grabitur pasagjerët e një furgoni, duke u marrë paratë që kishin me vete (shuma dyshohet të jetë 10 mijë euro). Mësohet se automjeti sapo kishte mbërritur me traget nga Italia, kur autorët e krimit i kanë zënë pritë. Burime nga policia lokale bënë me dije se ngjarja ka ndodhur mëngjesin e djeshëm në qendër të këtij qyteti. Menjëherë pas sinjalizimit për grabitjen, policia ka shkuar në vendngjarje dhe është vënë në ndjekje të grabitësve, ndërsa kanë sekuestruar dy kallashnikovë si dhe dy makina të përdorura nga agresorët. Blutë kanë arritur të kapin një nga autorët e krimit. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se është arrestuar 29-vjeçari Armand Kuqi, 29 vjeç, lindur në Mamurras dhe banues në Tiranë. Të njëjtat burime sqarojnë se policia ka identifikuar dhe autorin e dytë dhe se vijon puna për kapjen tjetër. Ndërkohë, është shoqëruar edhe një person i tretë, ndërsa po hetohet nëse është i përfshirë ose jo në ngjarjen e ndodhur. Për identifikimin dhe kapjen e autorëve janë angazhuar rreth 70 forca policore të përbëra nga shërbimet e komisarariatit, Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe Forcat Operacionale FNSH të Fierit. Për ndjekjen e autorëve po përdoret edhe qeni i gjurmës.

## NGJARJA

Sot rreth orës 09:05, në zonën e 'Skelës' pranë stadiumit "Flamurtari", 3 persona, dyshohet të maskuar

# Rikthehen maskat, grabitet me kallashnikovë furgoni me pasagjerë që sapo erdhi nga Italia

Autorët i zunë pritë mjetit te stadiumi "Flamurtari", arrestohet 29-vjeçari Armand Kuqi nga Mamurrasi



Policia vë në pranga një nga autorët e vjedhjes me armë



kanë vjedhur nën kërcënimin e armëve të zjarrit dhe dhunës shoferin e autobusit të linjës 'Itali-Vlorë', si dhe disa nga pasagjerët e mjetit. Autorët e ngjarjes pas grabitjes janë larguar menjëherë me dy automjete. Por pas tentativës për t'u shpëtuar forcave të policisë që ishin vënë në ndjekje të tyre, ata kanë braktisur mjetet me të cilët u larguan nga vendi i ngjarjes te nënkalmi i "Panajasë" dhe janë larguar në këmbë nëpër kodrat e

Panajasë për t'u fshehur në pyll. Pas një ndjekjeje për rreth 30 minuta u bë e mundur vënia në pranga e të riut Armand Kuqi, 29-vjeçari u kap në kodrat e Panajasë. Ndërkohë, policia vijon ndjekjen për kapjen e dy personave të tjerë, të cilët janë larguar me shpejtësi në kodrat përreth duke u futur në pyll, ku ende vijon krehja e zonës për kapjen e tyre. Në afërsi të vendit ku u kap autori i parë është konstatuar edhe një shtetas tjetër, i cili është

shoqëruar në polici e po punohet për të parë nëse ka ose jo lidhje me ngjarjen. Sipas hetuesve të çështjes, dyshohet se grabitësit janë grup i mirorganizuar, të ardhur nga Fushë-Kruja ose

Tirana dhe jo amatorë. Kjo, nisur nga dinamika e ngjarjes, kryerja e grabitjes në një zonë mjaft të populluar dhe largimi nga vendi i ngjarjes duke përdorur dy automjete për të humbur gjur-

mët. Policia vijon veprimet procedurale dhe hetimet e mëtejshme në lidhje me zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes. Operacioni vazhdon për kapjen e autorëve të tjerë.

## 30-vjeçari Florenc Xheleku u kap afër një lokali

Grabitën me armë zjarri banesën e 50-vjeçarit, përfundon në pranga një nga autorët

**BULQIZË** - Një 23-vjeçar nga Bulqiza ka përfunduar në pranga, pasi dyshohet të jetë autori kryesor i një grabitjeje me armë zjarri të ndodhur katër ditë më parë. I arrestuari është Florenc Xheleku, ndaj ndaj të cilit Gjykata e Lezhës ka caktuar masën "arrest në shtëpi". "Në vijim të hetimeve të pandërprera të kryera nga grupi i posaçëm hetimor, i ngritur nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibrë dhe Komisarriati i Policisë Bulqizë për zbardhjen e vjedhjes me armë të ndodhur më datën 22 shtator në Bulqizë, nga tërësia e veprimeve të kryera duke përdorur edhe metoda speciale të hetimit është bërë e mundur kapja dhe ndalimi i të dyshuarit si autori kryesor i ngjarjes, i cili ishte i shpallur në kërkim nga policia disa orë më vonë pasi ndodhi ngjarja dhe konkretisht shtetasi Florenc Xheleku, 23 vjeç, banues në Bulqizë, (Gjykata e Lezhës ka caktuar



masën e sigurisë 'Arrest në shtëpi' për veprën penale: 'Prodhimi dhe shitja e narkotikëve', thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkohë, blutë sqaruan se i riu dyshohet se të shtunën që shkoi, në bashkëpunim me dy shtetas të tjerë, të maskuar e që dyshohet se posedonin edhe armë, kanë hyrë në banesën e shtetasit A.M., 50 vjeç dhe pasi kanë kontrolluar për sende me vlerë, janë larguar duke marrë automjetin tip "Benz"

në pronësi të zotit të banesës, ku më pas ky automjet u gjet nga policia i braktisur. Ndërkaq, pohohet se Florenc Xheleku është arrestuar mbrëmjen e së hënës në afërsi të një lokali. "Shërbimet e Policisë nuk e kanë gjetur në banesë këtë shtetas pasi ka ndodhur ngjarja. Policia e Bulqizës ngriti pika kontrolli grackë, ku mbrëmjen e djeshme është kapur në afërsi të një lokali. Në momentin e kapjes ky shtetas ka bërë rezistencë ndaj punonjësve të policisë dhe ka tentuar të largohet, por është prangosur. Vija hetimit për identifikimin e personave të tjerë të implikuar në këtë ngjarje. Materialet hetimore do t'i referohen Prokurorisë Dibrë për veprat penale 'Vjedhje me armë', 'Armëmbajtje pa leje', 'Plagosje e lehtë', 'Veprime në kundërshtim me gjykatën' të kryera në bashkëpunim, 'Largim nga vendi i vuajtjes së dënimit', sqaruar burimet e mësipërme.



The United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) Representation in Albania is looking for Service "Database Development for the Ministry of Interior, Directorate for Asylum and Citizenship" and in this regard is publishing:

Request for Proposals with reference number "UNHCR/Albania/RFP/2018/002"

Request for Proposal together with General Conditions and Vendor Registration form can be found on: <http://www.un.org.al/> at the section Employment and Procurement.

Gjykata lë në burg kryeregjistruesin dhe vendos "Arrest shtëpie" për Frida Mirashin

SHKURT

**Moren rryshfet te biznesi, pranga dy inspektorëve te AKU**

**DURRES** - Policia e Durrësit ka reaguuar lidhur me investigimin e bërë nga "Fiks Fare", ku dy inspektorë të AKU marrin rryshfet. Të ndaluar janë: Arben Gupi 51 vjeç, banues në Durrës, inspektor pranë Drejtorisë së AKU-së; dhe Medi Çela 49 vjeç, banues në Durrës, inspektor pranë Drejtorisë së AKU-së. Gjithashtu, ka filluar procedimi penal në gjendje të lirë në ngarkim të shtetasit E.J. 26 vjeç, banues në Durrës, kamerier në subjektin privat që u kontrollua. Më datë 18.09.2018, shtetasit e mësipërm në detyrë inspektorë pranë AKU-së kanë ushtruar kontroll pranë një subjekti privat dhe nuk kanë mbajtur akt konstatimi, ku kamerieri i subjektit që u kontrollua u ka ofruar një sasi parash prej 8 000 lekë të reja, me qëllim që të mos e gjobisnin për mungesë të dokumentacionit higjieno-sanitar. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprimet të mëtejshme për veprat penale: "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", "Shpërdorimi i detyrës" në bashkëpunim dhe "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike".

**I izoloi batia, FNSh e policia shpëtojnë 2 peshkatarë në Velipojë**

**SHKODER** - Ndërhyrja në kohë e policisë dhe FNSh-së së Shkodrës, ka bërë të mundur shpëtimin e dy peshkatarëve, të cilët kishin mbetur të izoluar për shkak të baticës. Shtetasit B.T. 58 vjeç, dhe Gj.Z. 56 vjeç, të dy banues në Shkodër, kishin shkuar me varkë për të peshkuar dhe kishin hipur në një urë druri të prishur. Për shkak të baticës, varka është larguar nga vendi dhe peshkatarët kanë mbetur të izoluar në urë. Menjëherë pas marrjes së njoftimit se dy peshkatarë kishin mbetur të izoluar në një urë druri në fshatin Rrjoll në Velipojë, që lidh lagunën e Vilunit me Rjollin, policia e Shkodrës në bashkëpunim me FNSh kanë shkuar në ndihmë të tyre. "Falë ndërhyrjes së bluve dhe veçanërisht skuadrës speciale të emergjencave në FNSh u është dhënë ndihma e duhur ku rreth orës 23:50 (të së hënës) janë nxjerrë në breg pa probleme", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë.

# Korrupsioni, prangoset drejtori dhe juristja e Hipotekës së Shkodrës

*Prokuroria: Zamir Leka merrte para për regjistrimin e pasurive dhe lejet e legalizimeve*

Senad Nikshiqi

SHKODER

Zamir Leka, drejtor i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Shkodër është arrestuar dhe nga policia pas një urdhri të prokurorisë dhe pasi gjykata e këtij rrethi kishte pranuar kërkesën për masën e sigurisë "Arrest me burg". Mësohet se krye regjistruesi akuzohet për veprën penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike". Në vendimin e gjykatës për vendosjen e masës së arrestit thuhet se Leka ka pranuar të marrë para nga persona të tjerë në këmbim të regjistrimit të pronave. Sipas burimeve nga organi i akuzës, kreu i Hipotekës u prangos teksa ai ndodhej në ambientet e këtij institucioni, pak minuta para se të mbaronte orarin zyrtar të punës. Ndërkohë, për punonjësën e ZRVPP, juristen Frida Mirashi togat e zeza të Shkodrës kanë vendosur masën e sigurisë "Arrest shtëpie", pasi dyshohet po për të njëjtin akuzë. Të dy zyrtarët në fjalë janë pëzulluar nga detyra.



Zamir Leka, drejtor i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Shkodër



Juristja Frida Mirashi

**ARRESTIMI**

Rreth orës 15:50, policia e Shkodrës ka mësyrë në ambientet e Hipotekës, duke e prangosur në zyrën e tij drejtorin Zamir Leka dhe duke e shoqëruar në komisaratin policisë vendore. Sipas burimeve të mësipërme, Leka akuzohet për çështje korruptive gjatë kohës që drejtonite hipotekën e Shkodrës. Zamir Leka u emërua me 18 janar të këtij viti si drejtor i Hipotekës dhe pas 8 muajsh në atë pozicion policia dhe prokuroria e arrestojnë. Leka erdhi si kryeregjistrues në Shkodër pas ndryshimeve të bëra në rang kombëtar në drejtoritë vendore të Hipotekave në gjithë Shqipërinë. Bashkë me të sipas burimeve është arrestuar edhe shtetasja Frida Mirashi, punonjëse e hipotekës së Shkodrës, e cila, gjithashtu, dyshohet për të njëjtin rast korruptiv. Arrestimi i titullarit dhe punonjësës lidhet drejtpërdrejtë me arrestimet e gjashtë ditëve më parë. Më 21 shtator, prokuroria lëshoi urdhër ndalimi edhe për shtetasin Mirjam Bletaj, ish-jurist në hipotekën e Shkodrës gjatë viteve të fundit si dhe shtetasin Sokol Tirana që bashkë me shtetasin tjetër Johan Zefi dyshohet si sekserët që do i merrnin një mijë euro shtetasit Ndoc Taraj, ky i fundit pranon i një objekti që ishte i gatshëm të paguante para për të nxjerrë në mënyrë të pë-

**VENDIMI I GJYKATËS PËR ZAMIR LEKEN DHE FRIDA MARASHIN GJYKATA PRANOI KËRKESËN E PROKURORISË SHKODËR PËR:**

1. Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në burg", e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale dhe masën e sigurimit personal me karakter ndalues "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" e parashikuar nga neni 242 të Kodit të Procedurës Penale ndaj të dyshuarit Zamir Leka, me detyrë Regjistrues pranë ZVRPP Shkodër, i dyshuar për veprën penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i K.Penal.
2. Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhe masën e sigurimit personal me karakter ndalues "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" e parashikuar nga neni 242 të Kodit të Procedurës Penale ndaj të dyshuarës

Frida Mirashi, me detyrë juriste pranë ZVRPP Shkodër e dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i K.Penal.

Gjatë hetimeve paraprake ka rezultuar e provuar se shtetasi Zamir Leka, me detyrë regjistrues pranë ZVRPP Shkodër, në mënyrë të parregullt, pranon përfitime nga të tjerët, në këmbim të kryerjes së një veprimi, konkretisht regjistrimit të pasurive, lejeve të legalizimit, etj., detyrë funksionale kjo e tij.

Me dt.30.03.2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar kryesisht procedimin penal lidhur me veprat penale të parashikuara nga neni 245/1, paragrafi I dytë dhe 259 të K.Penal, në ngarkim të shtetasve Zamir Leka, A.H, J.Z, S.M, S.T. Në vijim të hetimeve, është regjistruar për llogari të këtij procedimi penal edhe emri i shtetasit M.B..

shpejtuar certifikatën e pronësisë. Gjykata e Shkodrës i la në "Arrest me burg" ish-juristin (anëtar i këshillit bashkiak të këtij qyteti), Mirjam Bletaj dhe dy sekserët e dyshuar Sokol Tirana dhe Johan Zefi, ndërsa dha masën e sigurisë "Arrest shtëpie" për shtetasin Ndoc Taraj. Para

këtyre arrestimeve në Hipotekën e Shkodrës që përfundojnë me ndalimin e drejtorit Zamir Leka, ministria e drejtësisë Etilda Gjonaj paralajmëroi se shumë shpejt do të niste goditja e rasteve korruptive në hipoteka duke filluar kështu nga Shkodra. Shteta-

sja Frida Mirashi është motra e drejtores së patentave në Shkodër Egla Mirashi. Kjo e fundit bashkë me drejtorin e Hipotekës Zamir Leka dhe disa drejtorë të tjerë rajonal në Shkodër, kohët e fundit përflireshin për t'u ndryshuar dhe zëvendësuar

**KRYEREGJISTRUESI**  
Zamir Leka u emërua me 18 janar të këtij viti si drejtor i Hipotekës dhe pas 8 muajsh në atë pozicion policia dhe prokuroria e arrestojnë. Leka erdhi si kryeregjistrues në Shkodër pas ndryshimeve të bëra në rang kombëtar në drejtoritë vendore të hipotekave në gjithë Shqipërinë.

**JURISTJA**  
Frida Mirashi është motra e drejtores së patentave në Shkodër Egla Mirashi. Kjo e fundit bashkë me drejtorin e Hipotekës Zamir Leka dhe disa drejtorë të tjerë rajonal në Shkodër, kohët e fundit përflireshin për t'u ndryshuar dhe zëvendësuar nga emra të tjerë. Sipas burimeve shtetasit Zamir Leka i është kërkuar dorëheqja pak ditë më parë si drejtor i Hipotekës në Shkodër, por ai nuk ka pranuar që ta japë duke vijuar detyrën derisa përfundoi i arrestuar dhe i dyshuar për çështje korruptive.

Ne kuader të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit material kombëtar për venien në funksionim të databazës shtetërore NISA, Dnoma Kombëtare e Notoresë (DH.K.N.) fton Operatorët Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë. Dokumentat e projektit mund të terhiqen perkundrejt pagesës prej **10.000 lekë**, prane Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tirane, Shqipëri. Propozimet do të pranohen brenda dates **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

Zyra e Përmbarrimit Albius, me përmbarrues gjyqësor privat Zef Macaj, në bazë të vendimit nr. 1857, datë 19 Shtator 2018, shpall shifren në anand të pasurisë pasurisë "Ndërtesa", me sipërfaqe 115 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 6/596/ND, volumni 37, faqe 111, zona kadastrale nr. 8120, me adresë : Rr. " Niko Avrami", Tiranë, në vlerën 43,361.6 (dyzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një, pikë gjashtë) Euro.

Ankandi zhvillohet në ambientet e Zyrës të Përmbarrimit Albius, në adresën : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr. 6, Hyrja nr. 3, Apartamenti nr. 8, Njësia Administrative nr. 10, 1001, Tiranë, ditën e Enjtë, me datë 19 Shtator 2018, ora 16.15.

**STUDIO PËRMBARRIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARRUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA**

Dt. 25.09.2018 ora 16:00  
Përfundon Ankandi i Parë për pasuritë:  
- Pasuria "Lokal nr.4" me sip.66 m<sup>2</sup>, me adresë L.13, Plazh Durrës.  
Me çmim 66 000 Euro  
- Pasuria "Lokal nr.5" me sip.43 m<sup>2</sup>, me adresë L.13, Plazh Durrës.  
Me çmim 51 600 Euro  
- Pasuria "Lokal nr.6" me sip.110 m<sup>2</sup>, me adresë L.13, Plazh Durrës.  
Me çmim 140 800 Euro  
Ankandi zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARRIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Btv.kryesor (ish Kinma Iliria), Kati-2, Durrës, Kontakti Çel 06829096575







Nr ID MATURE Piket e rrrumbullakosura

Table with 2 columns: ID, Piket e rrrumbullakosura. Lists various identification numbers and their corresponding locations.

DEGA PUNE SOCIALE

Nr ID MATURE Piket e rrrumbullakosura

Table with 2 columns: ID, Piket e rrrumbullakosura. Lists various identification numbers and their corresponding locations.

Table with 2 columns: ID, Piket e rrrumbullakosura. Lists various identification numbers and their corresponding locations.

GJEOGRAFI

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

GAZETARI

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

GJUHE -LETËRSI

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

HISTORI

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

ARKEOLOGJI

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

VITI AKADEMIK 2018-2019

NR ID MATURANTI PIKËT

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

RENDITJA E APLIKANTEVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT "LOGOPEDI", RAUNDI II-TË, VITI AKADEMIK 2018-2019

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

NR ID MATURANTI PIKËT

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

RENDITJA E APLIKANTEVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT "MAMI", RAUNDI II-TË, VITI AKADEMIK 2018-2019

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

NR ID MATURANTI PIKËT

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

RENDITJA E APLIKANTEVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT "FIZIOTERAPI", RAUNDI II-TË, VITI AKADEMIK 2018-2019

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.

NR ID MATURANTI PIKËT

Table with 3 columns: NR, ID MATURANTI, PIKËT. Lists candidates and their assigned locations.



SHOQËRIA PËRMBARËSË PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PËRMBARIMORE GJYEQSORE PRIVATE "ILIA ELEZI"

PASURIA ME NR. 27/1, E LLOJIT "ARË", VOLUMI I, FAQJE 169, ZONA KADASTRALE 3852, SIPËRFAQJE 4.453 M<sup>2</sup>, NE ADRESËN: XHAFZOTAJ, DËRËSË, NË PRONESI TË Z. NEXHMI VORA,

ÇMIMI 17.812.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 08.10.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866



SHOQËRIA PËRMBARËSË PRIVATE "3H" Sh.p.k Rr. "Fah Dëshia", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.25.09.2018 deri ne dt. 05.10.2018 për: sendin e luajtshëm mjek me targe AA 089 OB në pronesi të Subjektit Naber Konfeksion Shihaj shtëpi me NIPT J62208504M

Ankandi zhvillohet në zyrën përmbarimore në datën 05.10.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.

Pacolli në Nju Jork, takim me homologët e Ruandës dhe Bahamasit

# Mbledhja e OKB, Kosova lobon për njohjen e pavarësisë

## Grupi i BE-së për vizat, Hoxha: Gati materialet për progresin

Vijojnë prej tashmë disa ditësh takimet e shumta të përfaqësuesve të Kosovës në Nju Jork të SHBA-ve, ku dje nisi edhe asambleja e përgjithshme. Në kuadër të këtyre takimeve që kryediplomati kosovar, Behgjet Pacolli po zhvillon me homologët e tij, ka takuar ndaras edhe dy ministrat të Jashtëm të shteteve jonjohëse të Kosovës, respektivisht ministrin e Jashtëm të Bahamasit, Darren Allan Heinfeld dhe ministrin e Jashtëm të Ruandës, Louise Mushikiwabo. Gjatë këtyre takimeve është diskutuar mbi arritjet e Kosovës në dekadën e fundit, forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar, si dhe integrimin e saj në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare. Në këtë kontekst, është diskutuar edhe mundësia që këto dy shtete të rishqyrtojnë njohjen e Kosovës në një të ardhme të afërt si shtet i pavarur, në mënyrë që t'i bashkohet shumicës dërmuese të shteteve anëtare të OKB-së, si dhe të mbështesin integrimin e saj në organizata ndërkombëtare. Të dy homologët Pacolli kanë vlerësuar arritjet e Kosovës dhe rëndësinë e vendosjes së bashkëpunimit në funksion të interesave të përbashkëta. Ndërkaq, Grupi Punues për Vizat i Këshillit të Bashkimit Evropian të martën dhe të mërkurën do të qëndrojë në Kosovë për të parë nga afër progresin e institucioneve kosovare në sundimin e ligjit dhe të gështjeve tjera që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave. Ministria Dhurata



Ramush Haradinaj, Hashim Thaçi, Behgjet Pacolli

## Daçiç në OKB: Zgjidhja e çështjes së Kosovës, prioritet kombëtar

Ivica Daçiç, ministri i Jashtëm serb ka thënë se prioriteti nacional i Serbisë është gjetja e zgjidhjes politike për Kosovën. "Për Serbinë është i pakontestueshëm vendi qendror dhe roli i Kombeve të Bashkuara, ndërsa objektivat e parimit janë definuar me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sot janë njësoj të nevojshëm", ka thënë ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Ivica Daçiç në Samitin në Nju Jork, në prag të fillimit të Asamblesë së Përgjithshme. Sipas tij, Serbia mbështet pjesëmarrjen e vizave. Ministria Dhurata



barabartë të shteteve në sistemin e qeverisjes globale. Daçiç ka thënë se, "prioriteti nacional i Serbisë është gjetja e zgjidhjes politike për Kosovën". Ai ka shtuar se "Serbia është me sinjeritet e përkushtuar për paqe e dialog, i cili po zhvillohet

ndërmjet Beogradit e Prishtinës me ndërmjetësimin e BE-së si dhe implementimin e marrëveshjeve të arritura. Duke udhëhequr politike të përgjegjshme, do të bëjmë gjithçka që interesat e popujve tanë, pagja rajonale dhe stabiliteti të jenë të mbrojtura", ka thënë Daçiç sipas medieve serbe. Është e ditur se Serbia, duke pasur mbështetjen e Kinës dhe Rusisë, të cilat kanë veto në Këshillin e Sigurimit, do pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizatën botërore, prandaj edhe e thekson "rolin qendror" të OKB-së.

Hoxha thotë se janë përgatitur materialet e nevojshme për ta njoftuar këtë grup për progresin e arritur. Grupi Punues për Vizat (COWEB), i cili funksionon në kuadër të Këshillit të Bashkimit Evropian, nesër dhe pasnesër do të qëndrojë në Kosovë për të parë nga afër punën që është bërë nga institucionet kosovare sa u përket reformave, posaçërisht rreth sundimit të ligjit dhe të aspekteve tjera që ndërlihen me këtë proces. Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha ka thënë se Kosova ka përgatitur të gjitha materialet përkatëse për ta njoftuar këtë grup rreth punëve që janë bërë. Pas mbështetjes nga COWEB, çështja e heqjes së regjimit të vizave për Kosovën kalon në nivelin e ambasadorëve, që njihet si COREPER dhe në fund kërkohet miratimi nga ministri i vendeve anëtare të BE-së. Nga ana tjetër, ditën e djeshme nisi asambleja e përvitshme e OKB-së në Nju Jork ku sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres pritet të paraqesë një imazh të zymtë të shteteve në botë. Këtë vit, 133 liderë botërorë kanë njoftuar se do të jenë pjesë e sesionit në Asambelën e Përgjithshme, e cila përfundon punimet më 1 tetor. Mes pjesëmarrësve këtë vit janë edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi si dhe kryeministria serbe, Ana Brambiç.



Tajlandë, gjenden të vdekur milioneri dhe gruaja e tij

Trupat e një milioneri nga Mbretëria e Bashkuar dhe gruas së tij tajlandeze janë gjetur në veri të Tajlandës pothuajse një javë pasi policia nisi të dyshonte se një vrasës me pagesë kishte ekzekutuar krimin. Trupat e Alan Hogg, 64 vjeç dhe Nod Suddaen, po 64 vjeç u gjetën të varrosur në pronën e tyre në provincën Phrae. Policia thotë se Hogg, i cili ishte nga Edinburgu u qëllua me armë, ndërsa gruaja e tij u vra me një çekiq. Tre të dyshuar janë arrestuar. Ata thuhet se janë punësuar për të kryer sulmin nga vëllai i zonjës Suddaen, i cili është arrestuar gjithashtu. "Motivi për vrasjen thuhet se ishte një konflikt i brendshëm familjar mbi pronat", tha komandanti i policisë lokale, Manas Kerdasukho për agjencinë e lajmeve "AFP". Çifti u raportua i zhdukur javën e kaluar. Vrasësit e dyshuar u arrestuan pasi policia zbuloi një makinë që thuhet se ishte marrë nga prona e Hogg. Sipas "BBC"-së, ata më vonë pranuan vrasjen e Hogg dhe bashkëshortes së tij. Ambasada britanike në Tajlandë deri më tani nuk ka bërë koment publik për këtë çështje. Hogg u zhvendos në Tajlandë disa vjet më parë dhe kishte ndërtuar një vilë luksoze në Phrae.

# Vulin: Perëndimi po punon kundër interesit të Serbisë

## Korrigjimi i kufijve, presidentja kroate: Territori i ish-Jugosllavisë mbetet i paprekur

Në sajë të takimeve të shumta të Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi në Nju Jork të SHBA-ve, një ndër të është edhe presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar Kitarović. Në këtë takim, siç raporton "Vecernji.hr", mes Thaçit dhe Kitarović është diskutuar edhe për të shumëpërfolurin ndryshim të kufijve në Ballkan. "Ishte interesant takimi me Presidentin e Kosovës, Thaçi, rreth marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës dhe asaj që është dëgjuar së fundmi, ndryshimit të mundshëm të territoreve", është shprehur Kitarović. Thaçi vlerëson mbështetjen kroate, nuk përmend deklaratën e Kitarovićit për kufijtë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka takuar presidenten kroate, Kolinda Grabar-Kitarović, gjatë sesionit vjetor të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të

**ALEKSANDËR VULIN**  
"Ata të gjithë po punojnë kundër interesit të Serbisë për ta zgjidhur çështjen me Kosovën. Fuqitë e mëdha po punojnë që të parandalojnë Serbinë që të vendosë për veten dhe të zgjidhë problemin me Kosovën" është shprehur Vulin.



Ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, Aleksandar Vulin



Kitarović

**PRESIDENTJA KROATE**  
"Ne jemi tejet të kujdesshëm dhe kemi përcjellë argumentet tona se fakti i principeve të Komisionit të Badinterit rreth kufijve territorialë në ish-Jugosllavi duhet të mbetet i gdhendur në gurë", është shprehur Kolinda Grabar-Kitarović.

Bashkuara në Nju Jork, e cila ka theksuar: "Ne jemi tejet të kujdesshëm dhe kemi përcjellë argumentet tona se fakti i principeve të Komisionit të Badinterit rreth kufijve

territorialë në ish-Jugosllavi duhet të mbetet i gdhendur në gurë", ka shtuar ajo. Ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, Aleksandar Vulin, ka lëshuar akuzat në drejtim të

Perëndimit lidhur me dialogun me Kosovën. Sipas Vulin, po punohet në interes të Kosovës. "Ata të gjithë po punojnë kundër interesit të Serbisë për ta zgjidhur çështjen me Kos-

ovën. Fuqitë e mëdha po punojnë që të parandalojnë Serbinë që të vendosë për veten dhe të zgjidhë problemin me Kosovën", kështu është shprehur Vulin, transmeton

agjencia e lajmeve 'BETA'. Po ashtu, ai shtoi se Perëndimi nuk ka interes që Serbia të zgjidhë problematikën me Kosovën.

DEPRESIONI, NJIHUNI ME SIMPTOMAT FIZIKE

# SUMMER


pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E mërkurë 26 Shtator 2018



Enca ndryshon modelin e flokëve, kështu nuk e keni parë kurrë



Afërdita Dreshaj publikon foton e parë që bëri me bashkëshortin milioner

**BULEVARDI**  
POLITIK



- Rama "ndjek" Tahirin, shkon në mes të dhive në Nivcë
- Një bebe në OKB, kryeministria shkon në samit me vajzën
- Spiropali për "mallkimet" e opozitës: Kokë gjarpri laragan...
- Historike, lordi britanik martohet me një mashkull



Rrëfhet artisti: Pikturat e mia kanë dimension njerëzor

## OLGERT RAKIPLLARI:

# Ja e veçanta e artit tim, pse zgjodha tunelin

*"Bluja lidhet me gjendjen time shpirtërore"*

Grëfhet artisti: Pikturat e mia kanë dimension njerëzor

# Olgert Rakiplari:

## Ja e veçanta e artit tim, pse zgjodha tunelin

“Bluja lidhet me gjendjen time shpirtërore”

Egla Xhemali

Arti është një formë e bukur për të transfiguruar realitetin dhe jo vetëm. Këtë na e tregon Olgert Rakiplari, artisti që po sjell një frymë të re të perceptuarit të pikturës. Për herë të parë në Shqipëri merr jetë një projekt tejet i veçantë, që është zgjedhur qyteti i Gjirokastrës për ta aplikuar, kjo për arsyen se ai është gri dhe i duhen doemos disa kolore për ta dritësuar. Rakiplari gjithë artin e tij po e lë simbolikisht në një tunel që lidh dy lagje në këtë qytet. Është zgjedhur pikërisht ky vend për të hequr ndjesinë e frikës që mund të kenë njerëzit kur hyjnë në të. I frymëzuar nga qyteti artisti ka bërë një punë të jashtëzakonshme për të përfshirë edhe elementet etnografike në artin e tij. Sipas Olgertit ngjyrat e errëta transmetojnë lumturi e shpeshherë blunë miqtë e tij e cilësojnë sikur ta kishte ngjyrë të personalizuar. Në fakt, kjo është ngjyra që ai pëlqen të përdori më tepër në punët e tij pasi personifikon paqen e thellë shpirtërore. Piktori ka dëshirë të eksperimentojë ndaj dhe ka vendosur që krijimtarinë e tij ta shtrijë edhe aty ku njerëzit e kanë të vështirë të pranojnë se mund të bëhen vepra të bukura duke përdorur natyrisht dhe fantazi. Ne i urojmë suksese Olgertit dhe sa më shumë vepra të realizuara!

**Çfarë dimension i japin punëve të tua pikturat brenda në tunel?**

Pikturat e mia kanë një dimension më njerëzor dhe nëse flasim pikërisht për këtë lloj tuneli, ku unë zgjodha të realizoj punimin tim ajo i heq ndjenjen e frikës kur dikush hyn në të, përkundrazi e fton atë ta vizitojë dhe të ndihet më mirë teksa hyn nga njëra lagje dhe del nga lagjja tjetër e qytetit,



pasi ky tunel është i frekuentuar nga banorët e qytetit në përditshmerinë e tyre. Ndërsa për turistët që nuk e njohin pa këto lloj pikturash do të ngjallte hezitim në të shumtën e rasteve.

**Pse zgjodhe motive etnografike gjirokastrite?**

Një nga 4 temat që ishin vendosur për këtë projekt ishte dhe marrja në konsideratë e trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës. Duke qenë se Gjirokastra njihet edhe për trashëgiminë etnografike mendova t'i ndërthur këto elemente, inspirimin për të realizuar motivet etnografike ishte nga vizita ime në pazarin e vjetër të qytetit dhe aty spikata

disa qilima shumë interesante dhe nga aty fillova të skicoj elementet që më tërhoqën dhe për ta bërë disi më modern i shtova dhe forma me elegante.

**Çfarë tonalitetesh i ndryshojnë njeriut gjendjen shpirtërore?**

Lidhja e ngjyrave me gjendjen shpirtërore nuk është diçka e re, por e vërtetuar nga disa studime se gjendja shpirtërore ndikohet edhe nga ngjyrat që veshim apo na dominojnë në përditshmerinë tonë. Tonalitetet dhe ngjyrat e ndezura gjithmonë transmetojnë gëzim, na tregojnë se jemi të lumtur, ndihemi mirë dhe nuk kemi frikë të guxojmë. Por dhe ngjyrat



e errëta jo domosdoshmërisht transmetojnë të kundërtën, por kjo varet se ku përdoren në veshjet, produktet, markat etj.

**Cila ngjyrë të përcaktton ty, ndërsa je në këtë intervistë? Pse?**

Ngjyra blu, bluja, në fakt, është duke më shoqëruar për një kohë të gjatë edhe në krijimtarinë time, shpesh miqtë e mi e cilësojnë dhe periudha blu e Olgertit, në fillim nuk dija t'i jepja një shpjegim të saktë këtij fenomeni që instinktivisht krijimet e mia si

në pikturë ashtu edhe në dizajnet e mi dominonte ngjyra blu, por më pas kuptova se kishte të bënte dhe me gjendjen time shpirtërore.

Pasi tashmë jam në një gjendje shpirtërore shumë të mirë, dua të them në paqe me veten, pa u stresuar për gjithçka që më rrethonte, duke e marrë çdo gjë me qetësi dhe duke bërë zgjedhjet e duhura, këto veti i ka dhe vetë ngjyra blu.

**Çfarë është në perceptimin tënd një tunel brenda shpirtëthemesh, nuancash e motivesh?**




## Enca ndryshon modelin e flokëve, kështu nuk e keni parë kurrë

Ajo është një nga personazhet më të komentuar të show bizit shqiptar. Këngëtarja Enca Haxhia shfaqet gjithnjë mjaft ekstravagante në postimet e saj në rrjete sociale. Këtë herë e shohim me një paruke të kuqe e veshur në mënyrë tejet provokuese. E veshur me lëkurë ajo ka ekspozuar edhe njëherë gjoksin e saj bombastik. Duket se ajo po përgatitet për produksionin e saj më të fundit, i cili nga pamja e këngëtares premon të jetë sensual.



## Afërdita Dreshaj publikon foton e parë që bëri me bashkëshortin milioner

Pesë vite më parë, Afërdita Dreshaj takoi hokeistin çek, Jakub Kindl. Koha do të rridhte shpejt dhe më 29 qershor të 2018-ës ata do ta gjenin veten të martuar. Ishte Dreshaj ajo që postoi një foto përkrah të shoqit në stadium ku shkruante: "Si sot, pesë vite më parë takova dashurinë e jetës dhe kjo është fotografia jonë e parë bashkë. Sot është burri im!" Po kështu në një tjetër postim, këngëtarja tregoi se si u zgjua këtë mëngjes, me një buqetë trëndafilash mbi shtrat.



Zymtësia që tunelet tona në përgjithësi karakterizohen e sidomos ato të komunizmit pasi janë ndërtuar për luftën e ftohtë dhe te njerëzit kjo gjë ngjall një ndjenjë trishtimi dhe ankthi nëse vizitohen nga ata që e kanë përjetuar atë kohe. Tuneli në fjalë nuk ka shërbyer fiks për këtë gjë pasi mund të them se është ndoshta ndër më unikët që ne kemi duke qenë se ajo është ndërtuar për t'u mbrojtur nga një sulm i mundshëm, por që u përdor në masë të madhe nga qytetarët si një rrugë kalimi më e shkurtër mes dy

lagjeve. Duke i shtuar një game të gjerë nuancash dhe motivesh, mendoj se do e bënte më të këndshme këtë udhëtim nga njëra anë në tjetra qoftë kjo për të rriturit apo dhe fëmijët që shkojnë në shkollë çdo ditë nga ky tunel.

### Cili projekt të dha mundësinë të pikturorsh në tunelin e Gjirokastrës?

"Arte Camp" quhej projekti në të cilin unë konkurrova dhe u përzgjedha për të qenë pjesë e këtij kampi të organizuar nga Fondacioni Gjirokastra - GCDO dhe Rete delle Case del Quartiere

nën programin e Tandem Europe 2017-2018. Falë këtij projekti dhe stafit të saj profesional bëri që krijimtaria ime të mos ndikohej nga rrethana të tjera, por të bëhej pikërisht ajo që krijuesi ideoi.

### Pse mendove të shtosh ngjyra nëpër Gjirokastrë?

Tema e dytë e projektit ishte "Ngjyrat e humbura të Gjirokastrës" pasi dihet se dikur Gjirokastra ka qenë një qytet plot ngjyra, kam parasysh këtu shtëpitë karakteristike të saj që ishin të dekoruara së brendshmi kryesisht me elemente florenale plot ngjyra. Sot qytetin e dominon ngjyra gri e tij nisur dhe nga fakti që është qytet i gurtë. Disa elemente dekorative për një vend si tuneli do e bënin më miqësore për vizitorin për ta ftuar ta vizitonte atë.

### Përveç tuneleve, ku të pëlqen tjetër të pikturorsh?

Tuneli në këtë rast i shërbeu idesë që unë pata dhe e lidha me temën e kam të vështirë që të them diçka ekzakte pasi në periudhën në të cilën po kaloj me krijimtarinë jam duke eksperimentuar shumë lloj formash dhe hapësirash, mund të them se aktualisht jam pak më shumë i përqendruar të ndërthurja e pikturës tradicionale me atë dixhitale.

### Nëse dikush do guxonte të pikturonte në muret e shtëpisë tënde, deri ku do e lejoje?

Nëse ai/ajo do të gjente një hapësirë më tepër se ku të pikturonte atëherë do të ishte i/e lirë ta plotësonte atë hapësirë boshe.

## KESHILLA

Shumë prej nesh i njohim simptomat e depresionit. Por, ndoshta ju nuk e dini se depresioni mund të shoqërohet me shumë simptome të tjera fizike.

Në fakt, shumë njerëz vuajnë nga dhimbjet kronike e deri te simptomat fizike. Këtu përfaqësohen:

**Dhimbjet e kokës:** Këto paraqiten pothuajse tek të gjithë njerëzit me depresion. Nëse deri tani keni pasur dhimbje të mëdha të kokës, ato do të duken edhe më të mëdha nëse jeni në depresion.

**Dhimbje në shpinë:** Nëse tashmë vuani nga dhimbjet në shpinë, do të ishte edhe më keq nëse do të bëheshit depresiv.

**Dhimbje muskulore në vazhdimësi:** Natyrisht, çdo lloj i depresionit do ta zgjeronte këtë problem.

**Dhimbje gjoksi:** Gjithnjë duhet të keni parasysh se është me rëndësi vitale kontrollimi i gjoksit nga ndonjë ekspert. Do të mund të ishte shenjë e problemeve serioze me zemër. Por, depresioni mund të ndikojë që problemi të bëhet më i papërshtatshëm dhe dhimbjet të bëhen më të mëdha.

**Probleme digjестive:** Mund të ndiheni të dobët apo të keni marramendje. Ndoshta keni diarree apo do t'iu krijohet një ngërç kronik.

**Lodhje:** Nuk ka lidhje nëse flini shumë, pasi që prapë mund të ndjeheni të lodhur. Zgjim nga shtrati në mëngjes mund të duket i vështirë, ndoshta i pamundur.

**Pagjumësi:** Shumë njerëz me depresion nuk mund të flenë më për shkak të depresionit. Ata ose zgjohen shumë herët, ose nuk i merr gjumi kur hidhen në shtrat. Të tjerët flenë më shumë se normalisht.

**Ndryshime në oreks apo peshë:** Disa njerëz për shkak të depresionit humbin oreksin apo humbin në peshë. Të tjerët hanë më shumë, si p.sh karbohidrate, dhe shtojnë në peshë.

**Marramendje dhe pavarësi:** Për shkak të simptomave që paraqiten, shumë njerëz në depresion kurrë nuk kërkojnë ndihmë, sepse ata nuk e dinë se këto simptoma mund



# Depresioni, njihuni me simptomat fizike



të shkaktohen nga depresioni. Madje shumë mjek nuk mund t'i konstatojnë simptomat.

Këto simptome jo gjithnjë shfaqen në kokën tuaj. Depresioni mund të shkaktojë ndryshime të vërteta në trupin tuaj. Për më shumë, mund të ngadalësojë proceset digjестive, që mund të rezultojnë në probleme me lukth.

Depresioni duket të jetë ngushtë i lidhur me një disbalance të substancave kryesore në trup.

Këto substanca mund të jenë të ngjashme dhe të luajnë rol të rëndësishëm në atë se si e ndjeni dhimbjen. Kështu, shumë ekspertë mendojnë se depresioni mund t'iu bëjë që dhimbjen nga depresioni, ta ndjeni më ndryshe se të tjerët.

### Trajtimi i simptomave fizike

Në disa raste, trajtimi i depresionit me terapi apo me barëra, ose me të dyja, mund të zgjidhë problemet e sim-

ptomave fizike. Por, bëni kujdes që për çdo simptomë të vizitoni mjekun tuaj familjar. Jeni të gabuar nëse mendoni se simptomat largohen vetvetiu, dhe për këtë nevojitet trajtim i shtuar.

Mjeku juaj mund t'ju këshillojë që të përdorni barëra kundër lodhjes, kur ndjeni marramendje. Këto barëra bëjnë që ju të ndjeheni më të relaksuar dhe ju lejojnë të flini më mirë. Qëkur dhimbjet dhe depresio-

ni janë së bashku, lehtësimi i dhimbjeve madje mund të rrisë depresionin. Barëra anti-depresive, si Cymbalta dhe Effexor, mund të ndihmojnë në shërimin e dhimbjeve kronike. Gjithashtu, edhe trajtime tjera mund të ndihmojnë kur keni simptoma të dhimbjes. Disa tipe të terapive të fokusura, siç është përdorimi i doracakëve, mund t'iu mësojnë se si të veproni në situata të caktuara.



## Rama "ndjek" Tahirin, shkon në mes të dhive në Nivicë

Kryeministri Edi Rama shpërndau dje disa video në "Instastory" nga krahina e Labërisë. Rama ka shkuar në vendlindjen e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, në Nivicë, një fshat në Kurvelesh, që është shumë afër me Gusmarin, nga ku Tahiri na njohu pak javë më parë me oborrin e shtëpisë së familjes së tij. Rama ka postuar çaste nga momentet në Nivicë, ku ka filmuar një kope me dhi, ku dëgjohet zhurma e zileve të tyre. Nuk mund të mungonte në këtë udhëtim të kryeministrit, grupi i famshëm i kësaj zone, grupi i Bënçës me në krye Golik Jaupin. Jaupi ishte protagonist i videos ku këndohej në nder të ish-diktatorit Enver Hoxha, bashkë me kryebashkiakun e Tepelenës, Tërmet Peçi. Rama shkruan: "Labëri, jo shaka! Ndërsa në vargjet e këngës thuhet: Labëria ime, malet si supe mbi mëngë, sipër detit të argjendtë".



## Një bebenë OKB, kryeministrja shkonnë samit me vajzën

Kryeministrja e Zelandës së Re, Jacinda Ardern ka hyrë në histori si udhëheqësja e parë botërore që merr pjesë në Asambleenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara me foshnjën e saj të porsalin-dur në prehër. Ajo u shfaq me vogëlushen e saj 3-muajshe në OKB, mbremjen e së hënës në Samitin e Paqes "Nelson Mandela". Ndërsa në momentin që po fliste, partneri Clarke Gayford mban-te të voglën, shkruan "Telegraph.co.uk". Kryeministrja ushqen me gjë të bijën, gjë që ka bërë që ajo të udhëtojë me nënën e saj në Nju Jork për udhëtimin gjasthëditor. Partneri i Ardern, një prezantues televiziv, është kujdestari kryesor i Neve dhe ka udhëtuar me kryeministren në Nju Jork për t'u kujdesur për foshnjën. Javën e shkuar, në Zelandën e Re u miratua një ligj që lejonte kryeministren apo ministrat të udhëtonin me një dado në misionet jashtë vendit, e kjo do të mbulohej nga taksapaguesit. Por, Ardern tha se bileta e partnerit për në Nju Jork dhe shpenzimet e tjera do të paguheshin prej saj.



# BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊



## Spiropali për "mallkimet" e opozitës: Kokë gjarpri laragan...

Deputetja e PS, Elisa Spiropali publikon këtë foto bashkë me një mesazh për opozitën, e cila siç thotë ajo, i kujton korin e magjistriceve të "Makbethi". Spiropali e ilustron këtë edhe me vargje nga vepra e famshme. "E dini ç'më kujtojnë mallkimet e opozitës së bashkuar nga sallat e hoteleve ku zbardhin të zezën e të bardhën nxijnë?! Korin e magjistricave tek 'Makbethi'. Ja, a s'kam të drejtë?! Kokë gjarpri laragan, ziej, piqiu në kazan, sy kuçedre, bisht bretkose, gjuhë qeni, qime dose, s'furk nepërke, thumb prej grere, Panç akrepi, gjemb prej ferre, për magji e gjëmë ferri, zieni si çorbë derri", shprehet Spiropali.



## Historike, lordi britanik martohet me një mashkull

Lordi Ivar Mountbatten, i divorcuar dhe baba i tre vajzave martohet me një mashkull, partnerin e tij, James Coyle. Kushëriri i largët Mbretëreshës Elizabeth nga ana e bashkëshortit të saj është i pari në familjen mbretërore që ndërmerr një hap të tillë. 24 orë më parë, Lordi Ivan dhe i dashuri i tij James Coyle shkëmbyen unazat me njëri-tjetrin në prani të 60 familjarëve të tyre, përfshirë tri vajzat dhe ish-bashkëshorten e tij shkruan "Daily Mail". Për habi të të gjithëve, ish-bashkëshortja ishte e lumtur për vendimin, madje pozoj në një foto mes tyre. Lord Ivar Mountbatten ka qenë i martuar 13 vjet me Penelope me të cilën ka edhe tri vajza. Kjo dasmë është e para e këtij lloji dhe më e veçanta në historinë e familjes mbretërore britanike.







Dje në "Deutsche Welle"

# Pse e bojkotoi Vuçiç Asamblenë e OKB-së?

Nga Ivica Petrovic

(vijon nga faqja 1)

...i heshtur i Brukselit dhe Uashingtonit. Vendimin e ka marrë Vuçiç, por e ka publikuar udhëheqësi i zyrës për Kosovën, Marko Gjuriç, i cili tha se Brukseli duhet të presë pak për vizitën e ardhshme të Vuçiçit atje. Ndërkohë që Vuçiç nuk do të marrë pjesë as në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Në Nju Jork do të udhëtojë kryeministrja Ana Brnabić.

Gjuriç shpjegoi se Vuçiç ka ofruar disa zgjidhje për çështjen e Kosovës, por atë e kanë kritikuar shumë për këto ide. Gjuriç tha se presidenti i Serbisë është përbalhur me heshtje, me distancim nga idetë e tij, e madje edhe "me sulme të tmerrshme", ndaj Gjuriç tha se në Bruksel "tani do të presin edhe ca kohë deri sa Vuçiç të shkojë në takimin e ardhshëm".

## PSE ËSHTË ZEMËRUAR PRESIDENTI?

Nëse zemërimi i presidentit të Serbisë, Vuçiç ndërlihet me idetë e tij për përkufizim me Kosovën, atëherë nuk dihet saktë se për cilat sulme të bashkësisë ndërkombëtare e ka fjalën Gjuriç. Ideja për përkufizimin, ndarjen e territoreve apo shkëmbimin e tyre, nuk është pritur me ndonjë entuziazëm të madh në disa vende perëndimore, por është tërësisht e tepruar të thuhet se për këto ide Vuçiç "është përbalhur me sulmet më të tmerrshme". Në disa vende ka pasur madje mirëkuptim për idetë e Vuçiçit.

Një numër i madh i diplomatëve evropianë ka bërë të ditur - ndonëse me shumë kujdes - se janë të pranueshme marrëveshjet që arrihen mes Prishtinës dhe Beogradit, e shikuar nga shkrimet e mediave serbe, më së paku kundërshtime për këto ide ka pasur në SHBA. Mediat serbe kanë bërë madje gara me shkrimet se administrata amerikane e ka ndryshuar qëndrimin dhe se ajo nuk ka asgjë kundër zgjidhjeve, të cilat do të nënkuptonin ndonjë lloj ndarjeje apo përkufizimi.

Po pse është i zemëruar Vuçiç pra? Naim Leo Beshiri, drejtor i Institutit për Çështje Evropiane thotë se, "Vuçiçi zemërohet tepër



© picture-alliance/AA/Council of the European Union

shpesh dhe ne shpesh nuk e dimë fare pse është zemëruar presidenti. Skenarë të ndryshëm për zgjidhjen e çështjes së Kosovës janë paraqitur në opinion, por ne kurrë nuk kemi marrë ndonjë konfirmim zyrtar se cili është propozimi i autoriteteve serbe. Ne vetëm dimë se Serbisë nuk i përgjigjet *status quo*-ja, që do të thotë se ajo angazhohet për përkufizim, korrigjimin e kufijve, shkëmbimin e territoreve, por përgjigjen e saktë nuk e kemi marrë kurrë. Ndaj kam frikë se fjalët e Gjuriçit janë vetëm një truk për opinionin e brendshëm. Kjo duhet të bindë qytetarët serbë se Vuçiç ka bërë gjithçka brenda mundësive të tij, por bashkësia ndërkombëtare nuk është e gatshme t'i pranojë kërkesat tona. Ndaj kur të vijë koha e nënshkrimit të marrëveshjes me Kosovën, do të kërkojë mbështetjen e qytetarëve në referendum, sepse ndonjë zgjidhje tjetër nuk ka qenë e mun-

dur", mendon Beshiri.

## BRUKSELI NË AKULL

Gazetari i revistës 'NIN', Vladan Marjanović thotë se Gjuriç shpesh tingëllon si një komik 'stand-up' dhe si e tillë mund të konsiderohet edhe deklarata e tij. "Thuhet se Bashkimit Evropian do t'i jepet kohë e mjaftueshme që të kuptojë se sa ka gabuar ndaj Vuçiçit dhe qëndrimin të tij heroik për 'zgjidhjen' e çështjes së Kosovës, ndonëse Vuçiç e ka pranuar në fjalimin e tij në Mitrovicë se ai nuk ka ndonjë zgjidhje. E kur BE ta kuptojë gabimin, atëherë Vuçiç do të mëshirojë dhe do të shkojë në bisedime. Ndërkohë, autoritetet serbe do të bartin me krenari gjithë këtë mllaf ndaj mosmirëkuptimit të ideve të Vuçiçit në Bruksel dhe Berlin", thotë Marjanović.

Pamje nga takimet e mëparshme të Mogherinit me Hashim Thaçin dhe Aleksandar Vuçiçin. Është shumë e qartë që Gjuriç

në këtë rast është vetëm bartës i fjalëve të Vuçiçit. Por duket qartë se Vuçiç është kaq i zemëruar me Perëndimin saqë vendimin e tij e ka kumtuar dikush tjetër, e jo ai vetë. Vladan Marjanović thotë se me këtë vendim Beogradi sugjeron se "ka qenë i gatshëm për kompromise, por tani për një kohë të caktuar do të ketë qëndrime shumë të ngurta. Kjo nënkupton mundësinë e vazhimit të moszgjidhjes së çështjes së Kosovës, që sipas të gjitha gjasave është edhe qëllimi përfundimtar".

## ZEMËRIMI ËSHTË DËSHMI I (PA)AFTËSISË

Aleksandar Vuçiç ka vendosur të mbajë inat me bashkësinë ndërkombëtare, por qytetarët e Serbisë më shumë janë të interesuar të dinë se çfarë mund të arrihet me këtë politikë dhe diplomaci. Ndoshta dikush në pushtetin serb ka menduar se autoritetet perëndimore do të shqetësohen dhe nuk do të flenë të qetë pas

zemërimit të Vuçiçit, por kjo dëshmon se diplomacia serbe është në një krizë shumë më të thellë sesa mendohet. A mund të ketë me mjete të këtitla një zgjidhje më të mirë për Serbinë në çështjen e Kosovës?

Naim Leo Beshiri thotë se, "me këtë sjellje infantile nuk mund të arrihet asgjë. E gjitha kjo është vetëm për përdorim të brendshëm, me qëllim që mbështetësit e Vuçiçit të mund të thonë se Vuçiç ka mundësi që të zemërohet me dikë dhe të mos flasë me ta. Asgjë pozitive nuk mund të ketë nga refuzimi i bisedimeve, sepse pa bisedime me Brukselin dhe qendrat e tjera ndërkombëtare, çështja me siguri nuk do të zgjidhet. Kjo do të thotë se bisedimet duhet të vazhdojnë, madje edhe me ata me të cilët nuk pajtohesh, e nëse bisedimet vazhdojnë, shtohet edhe mundësia e gjetjes së një kompromisi", konstaton Beshiri.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Opinioni *i* Ditës

# Gjenocidi grek në Çamëri, vepër më e rëndë se Holokausti

Nga Spartak Ngjela

(vijon nga faja 1)

... se është në proces, a do t'iu drejtohet USA edhe shqiptarëve të Greqisë për t'iu dhënë atyre të gjitha të drejtat e mohuara nga ardhacakët e Mikroazisë dhe të një kishe greke, që ka afër 150 vjet që është një detashment ushtarak i ngritur kundër shqiptarëve dhe gjuhës shqipe?

Po Vatikani, a do t'i ekspozojë të gjitha dokumentet në mënyrë që të rishkruhet historia e shqiptarëve ashtu siç ka qenë, një heroikë antiosmane dhe në mbijetesë nga lufta shfarosëse që kanë dashur t'i bëjnë Arbërisë me asimilim rusët, serbët dhe osmanët?

Politika austrohungareze ishte e para ajo që e kapi që, me përrjashim të kroatëve dhe sllovenëve, politika sllave në Ballkanin Perëndimor ishte kryekëput tzipërdimor, sepse drejtohej tërësisht nga Rusia.

Por, ishin austriakët dhe gjermanët gjithashtu që e kapën të parët se vetëm shqiptarët janë faktor i vendimtar që Perëndimi të fitonte luftën kundër Rusisë në Ballkanin Perëndimor. Në të njëjtën kohë ishte edhe ndërhyrja amerikane që e mposhti valën më të madhe antishqiptare të traktatit të Londrës për aneksimin tërësor të territoreve të Shqipërisë dhe shuarjen e saj si shtet.

Ndërkaq, duhet të themi se e gjithë historia e Gadishullit Ilirik, që nga viti 1100 e deri më sot ka qenë vazhdimisht një luftë kundër arbitrit dhe gjuhës shqipe. Pikërisht këtu, të shqiptarët, është mbështetur sot edhe filozofia amerikane për shkatërrimin e prezencës ruse në këtë zonë. Se pyetja mbetet të jetë kjo: me kë do të jenë pesëmbëdhjetë milionë shqiptarët e Gadishullit Ilirik?

Por cila ka qenë kapja amerikane dhe si ka ecur politika shqiptarë në Ballkanin Perëndimor? Kapja amerikane ka qenë faktori specifik se vetëm bota shqiptare në Ballkanin Perëndimor mund ta mposhtë egërsinë ruso-serbe në këtë zonë. Dhe, kjo kapje konsiston në faktin se të gjitha shtetet sllave të Ballkanit Perëndimor potencialisht janë të dominuar nga shqiptarët, sepse shqiptarët kanë qenë luftuar në mënyrë çnjerëzore nga serbët dhe Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia janë shtete sllave që janë ngritur mbi territoriet shqiptare dhe me anë të gjenocidit antishqiptar.

Çlirimi i shqiptarëve, do të shkatërronte Rusinë në Ballkan - kjo ishte filozofia e re amerikane pas rënies së komunizmit. Dhe ky proces filloi nga Amerika në vitin 1999 me çlirimin e Kosovës. Pastaj vijoi me Luftën e shqiptarëve në Maqedoni, fitimin e të drejtave nga shqiptarët dhe krijimi i shtetit të ri që do të vendoset brenda kësaj vjeshte. Tani dihet se luftën e UÇK-së në Maqedoni në vitet 2000-2001 e ka drejtuar politika amerikane.



ijimi i shtetit të ri që do të vendoset brenda kësaj vjeshte. Tani dihet se luftën e UÇK-së në Maqedoni në vitet 2000-2001 e ka drejtuar politika amerikane.

Së shpejti pritet të dalë edhe republika shqiptare brenda federatës së shtetit të riemëruar maqedon, por procesi është ende në mes të ecurisë së tij, sepse pyetja që duhet të ngrihet është kjo: Po të drejtat e shqiptarëve të persekutuar në Greqi, a do të kërkojen nga USA?

Por ka edhe një sërë pyetjesh që janë edhe më kryesore: A e di USA që në Greqi vetëm arvanitasit dhe çamët janë proamerikanë?

A e di USA që nëse shqiptarët do të përkrahen, politika ruse humbet çdo shpresë në Greqi?

A e di USA se arvanitasit janë pjesa më e pasur e Greqisë?

A e di USA që çamët ortodoksë që i kanë shpëtuar gjenocidit antishqiptar janë pjesa më e perseku-

tuar në rrafsh botëror?

A e di USA që nëse triumfojnë arvanitasit me gjuhën e tyre shqipe në Greqi, Rusia e humbet përfundimisht luftën kundër Amerikës në Ballkanin Perëndimor?

A e di USA që në Greqi nuk ka grekë, por vetëm shqiptarë dhe ardhacakë të Mikroazisë që e quajnë veten grekë?

A e di USA që historia e arbitrit është e fshehur dhe që greqishtja e vjetër e Sokratit sot shpjegohet vetëm me gjuhën shqipe?

A e di USA që Çamëria është Shqipëri dhe shqiptarë nga Janina e deri në Prevezë janë vazhdimësi e shqiptarëve të Shqipërisë?

A e ka studiuar USA gjenocidin antishqiptar në Çamëri, e cila është vepër çnjerëzore më e rëndë se holokausti i hebrejve?

Sigurisht që politika amerikane i di të gjitha këto, se tani këto ia ka hedhur në tryezë shkenca historike amerikane. Shqiptarët e

Greqisë janë: shqiptarët e vjetër të Akropolit (arvanitasit) dhe shqiptarët e rinj si zgjatim i shtetit shqiptar: sekretet nga Janina e deri Prevezë, ku sigurisht që hyn edhe Çamëria.

Por, pikërisht të Çamëria e shkatërruar me gjenocid antishqiptar do vijë sot e do të bëhet Thembra e Akilit ku duhet të mbështetet fillimisht politika amerikane, për ta trajtuar realisht njëllot si çështja e Kosovës edhe çështjen e Çamërisë. Se pastaj, procesi shqiptar ecën vetë.

Zotërinj, historia është shkencë dhe historianët e mëdhenj amerikanë dhe britanikë e kanë zbrëthyer plotësisht historinë nëntëqindvjeçare antishqiptare në Gadishullin Ilirik.

IV. Po politika shqiptare në Shqipëri si e sheh këtë fenomen? Shqipëria sot drejtohet jo vetëm nga injorantë të korruptuar, por edhe nga politikanët të rangjeve të ulëta dhe me kryeministra që janë të blerë nga Beogradi dhe nga Athina, aneksuesit e mëdhenj të territoreve shqiptare.

Reforma në Drejtësi, e formuluar nga Amerika dhe Gjermania do të sjellë likuidimin e të gjithë halldupëve të pavlerë, që janë kundër Shqipërisë dhe shqiptarëve. Kjo tani është një kastë politike që ka jetuar me korruption dhe me shitjen e interesit kombëtar.

Kurse politika e re shqiptare pa dyshim që do të ecë sipas doktrinës amerikane për bashkimin tërësor të të gjithë botës shqiptare në Gadishullin Ilirik, për të sjellë realisht frymën perëndimorë në Ballkanin Perëndimor.

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Performanca e fëmijës suaj do t'ju kënaqë pamasë. Dikush me plane dhe ide të mëdha do t'ju tërheqë vëmendjen. Megjithatë, përpiguni që të verifikoni besueshmërinë e tij. Mos i lejoni të tjerët të përfitojnë nga bujaria juaj. Një i afërmi do t'ju surprizojë sot.

**DEMI**  
Pacientët që vuajnë nga tensioni duhet të bëjnë kujdes. Një zhvillim i rëndësishëm në aspektin personal do t'ju lumtojë ju dhe familjarët tuaj. Përpiguni të kontrolloni fjalët nëse partneri/partnerja juaj nuk mban premtimet, pasi mund të përfundoni në përplasje me njëri-tjetrin.

**BINJAKET**  
Një mik mund t'ju vërë në provë tolerancën. Bëni shumë kujdes kur të merrni vendime. Stili ekstravagant i jetesës suaj mund të shkaktojë tension në familje. Sa i përket anës romantike, do të kaloni vërtet momente shumë të bukura sot.

**GAFORJA**  
Ka gjasa që sot të çlirohni nga një sëmundje afatgjatë. Miqtë do të ndërhyjnë më shumë seç duhet në jetën tuaj personale. Do të bënit mirë nëse do të relakseshit me partnerin/partnerin tuaj. Ka gjasa t'ju kontaktojë dikush me të cilin keni qenë mjaft i lidhur në të kaluarën.

**LUANI**  
Mirësjellja juaj do të vlerësohet shumë. Disa persona do t'ju komplimentojnë. Nëse pranoi gabimet në punë, do t'ju kthehet në avantazh. Kërkoji ndjesë personit që mund të keni lënduar.

**VIRGJERESHA**  
Do të ndiheni të lodhur fizikisht, por njëkohësisht edhe të stresuar. Do të fitoni të ardhura nga një burim i paplanifikuar, çfarë do t'ju ndriçojë ditën. Dialogu dhe bashkëpunimi do t'ju përmirësojnë marrëdhënien me bashkëshortin/bashkëshorten.

**PESHORJA**  
Përpiguni të shmangni stresin duke lexuar. Ka gjasa të zbuloni një sekret që do t'ju lërë pa fjalë. Partneri/partnerja juaj do të tregohet shumë kërkues/e sot, duke shkakuar pakënaqësi mes jush.

**AKREPI**  
Mbani diçkë nën kontroll për të qëndruar në formë. Do të keni dëshirë të bëni një udhëtim dhe të shpenzoni para. Ndihma e prindërve në marrjen e një vendimi do të jetë shumë e rëndësishme. Dita e duhur për të zbatuar projekte dhe plane të reja.

**SHIGJETARI**  
Bëni kujdes me disa veprime bankare. Miqtë dhe anëtarët e familjes do t'ju inkurajojnë gjatë gjithë kohës. Sot do të kuptoni se sa ju do partneri/partnerja. Sa u përket çifteve të martuar, sot do të përjetoni avantazhet e martesës.

**BRICJAPI**  
Mos investoni në disa skema të dyshimta financiare. Ka gjasa që dikush t'ju shprehë ndjenjat që ka ndaj jush prej disa kohësh. Mund të përballeni me disa probleme në punë. Shmangni personat që qëndrojnë pranë jush vetëm kur kanë interes.

**UJORI**  
Shmangni investimet afatgjata dhe përpiguni të kaloni disa momente të këndshme me miq të mirë. Do të jetë një mbremje më e bukur seç e kishit parashikuar. Romanca do të udhëheqë mendjen dhe zemrën tuaj.

**PESHQIT**  
Bëni kujdes me shëndetin. Të ardhurat nuk do të jenë në nivelin që ju prisnit. Është koha e duhur që të shtoni kontaktet me vendet e tjera. Ka gjasa që të grindeni me partnerin/partneren tuaj.

Sentamu shpërthen me tregolësh te bardheblutë, te të kuqtë Çinari shënon dy gola

# Tirana e Partizani ngrohjin motorët para derbit

## Kryeqytetaset fitojnë me rezultat të njëjtë, 4-0



Jeton Selimi

Partizani dhe Tirana kanë luajtur ndeshjet e kthimit të Kupës së Shqipërisë një ditë para skuadrave të tjera, duke qenë se të premtën luajnë derbin për javën e 6-të të Superiores. Partizani luajti me Tërbinun në Pezë Helmës dhe fitoi 4-0, me gola të Çinarit në minutën e 16-të e 38-të, Bardhit në minutën e 29-të dhe Heabajt në minutën e 83-të. Të kuqtë e kishin fituar 0-1 ndeshjen e parë dhe kualifikimi ishte formalitet. Trajneri Gega e nisi ndeshjen me këtë formacion: Xhika, Gojkoviç, Bitri, Kalari, Hyzenaj, So Hyon, Kote, Kodra, Bardhi, Heabaj, Çinari. Tirana luajti me Ilirinë dhe fitoi 4-0, me gola të Sentamu në minutën e 24-t, 30-të dhe 40-të, si dhe të Majkëll Ngo në minutën e 80-të. Bardheblutë e kishin fituar ndeshjen e parë 1-4. Tregolëshi i Sentamu është një sinjal për trajnerin Ze Maria se ai është gati për derbin.

**TIRANA**  
Në kampin e Tiranës, ishte dita e Junus Sentamut, i cili shënoi një tripletë. Të parin e shënoi pas një topi të gjatë të Karabecit, dhe u gandezi shënoi i vetëm me portierin. Në golin e dytë, pas një kombinimi me sulmuesin Ngo, është Sentamu që del para portës dhe godet pa vështirësi. Ndërkohë, tripletën e plotësoi pas një krosi të Ismailgecit, dhe Sentamu vetëm sa shtyu topin në rrjetë. Në pjesën e dytë, rrugën e rrjetës e gjeti edhe Ngo, i cili u shërbye



nga Muçi nga krahu i djathtë, dhe vetëm me portierin goditi e shënoi.

Në turin tjetër Tirana luan me fituesin e çiftit Flamurtari-Shkumbini, kurse Partizani me fituesin e çiftit Kastrioti-Korabi.

**PARTIZANI**  
Në provat gjenerale para derbit, Tirana e Partizani shkëlqyen në ndeshjet e kthimit në Kupën e Shqipërisë, teksa të dyja fituan me shifrat 4-0. Partizani priste ekipin e Tërbinut në Pezë, dhe me sfidën e parë që ishte mbyllur me shifrat 1-0, "denat" nuk u ndalën. Goli i parë i të kuqve u shënuar nga Çinari me

### Sulmuesi i Uotfordit: E urrej Van Dajkun!

Sulmuesi dhe kapiteni i Uotford, Troi Dini ka folur para sfidës mes skuadrës së tij dhe Liverpoolit. Dini konsiderohet si një nga sulmuesit më të fuqishëm në Premier Ligë dhe është shumë pranë edhe një thirrjeje nga tekniku Southampton për në kombëtaren angleze. Me 2 gola të shënuar dhe me 4 asiste në 5 ndeshje në Premier Ligë, Dini po shijon një moment shumë të mirë në karrierë, por tashmë do t'i duhet të përballat me gjigantin e Liverpool, Van Dajk, për të cilin ka thënë: "Van Dajk? (qesh) E urrej! Është shumë i madh, i fuqishëm dhe të mashtron me aromën e tij. Mban erë shumë të mirë (qesh) dhe të jep përshtypjen se është një djalë i mirë dhe i urtë, por bërrylat që sulmuesit marrin nga ai nuk kalohen kollaj. Do të jetë një përplasje interesante dhe një duel i bukur për t'u parë nga tifozët, por jo për ne të dy", premtoi Dini.



### Arrestimi i Grimajt, jehonë në mediat spanjolle

Arrestimi i Armir Grimajt, trajnerit të përfaqësueses shqiptare të futbollit të femrave ka bërë shumë bujë jashtë Shqipërisë dhe ngjarja në fjalë është pasqyruar edhe në mediat e njohura ndërkombëtare. Kështu, dy të përditshmet sportive spanjolle, "AS" dhe "Mundo Deportivo", i kanë dhënë rëndësi kësaj ngjarjeje ndoshta më shumë se në Shqipëri, duke publikuar të dhënat e saj mbi trajnerin shqiptar "AS" shkruan se trajneri i përfaqësueses së femrave të Shqipërisë ishte pjesë e një grupi kriminal që akuzohej ndër të tjera për vrasje, armëmbajtje pa leje, prodhim e tregtim lëndësh narkotike, e manipulime ndeshjesh futbolli. Ajo shpjegonte se Grima ishte "portieri legjendar i Vllaznisë" dhe se bashkë me të ishte arrestuar edhe Fabjol Rexhepi, portieri i Tërbinut. Sa i përket "Mundo Deportivo", ajo shpjegon, gjithashtu, rrethanat e arrestimit të Grimës dhe dyshimet se është pjesë e "Grupit Bajri" në një operacion policor që ishte zhvilluar në Shqipëri, Holandë e Belgjikë dhe hetimet kishin zgjatur disa muaj. Gjykata e Krimeve të Rënda dhe dje masën "arrest me burg" për Grimën, ndërsa Federata Shqiptare e Futbollit e pezulloi përkohësisht trajnerin e përfaqësueses së femrave.

KUPA E SHQIPËRISË	
Java e 5-të	
<b>Grupi A</b>	
Partizani-Tërbinun	4-0
<b>Grupi B</b>	
Tirana-Iliria	4-0

kokë, ndërsa në atë moment, mbrojtja kundërshtare e mendoj lojtarin e kuq si në pozicion jashtë loje. I dyti u shënuar nga Jurgen Bardhi, një goditje ballore, drejtpërdrejt në kuadrat, nga rreth 20 metra largësi. Më pas, erdhi edhe rrjeta e dytë e Çinarit, i cili shënoi me një parabolë mbi portierin. Interesant është fakti se ndeshja e kthimit të këtë tur të Kupës, përkon me javën e derbit, dhe interesi është i madh në kompleksin e Pezës, ku po zhvillohet edhe sfida. Rreth 300 tifozë, po ndjekin nga afër takimin e kthimit të Partizanit ndaj Tërbinut. Ndërkohë, edhe në ndeshjen tjetër, Tirana fitoi po me shifrat 4-0 ndaj Ilirisë, ndërkohë që ndeshjen e parë e kishte fituar në transfertë 1-4. Kujtojmë që Tirana e Partizani luajtën 24 orë para ekipeve të tjera, sepse luajnë ditën e premtë derbin.

### ISH-TRAJNERI KUQEZI

#### Xhani De Biazi pranë stolit të Armenisë



Që nga koha kur la Kombëtaren shqiptare, Xhani De Biazi nuk ka pasur kujtime të bukura në stol, duke u larguar edhe nga Alavesh për rezultate të dobëta, ndërkohë që aktualisht ai është pa një skuadër. Megjithatë, duket se po i buzëqesh fati trajnerit italian që është shumë pranë drejtimit të një kombëtareje. Mediat armenë, bëjnë më dije se trajneri me pasaportë shqiptare ka udhëtuar drejt Armenisë për të takuar presidentin e Federatës Armenie të Futbollit, në mënyrë që De Biazi të marrë drejtimin e skuadrës. Rezultatet e

fundit nuk kanë bindur pasi në dy takimet e para në Ligën e Kombeve, Armenia ka marrë vetëm 3 pikë. De Biazi mund të zërë vendin e Vardan Miniasan që është aktualisht trajner i përkohshëm në skuadër. Kujtojmë që Armenia ishte

në grup me Shqipërinë në eliminoret e Europanit 2016, aty ku kuqezinjët arritën të kualifikoheshin duke mundur dy herë Armeninë, si në "Elbasan Arena", ashtu edhe në transfertë dhe trajner atë kohë të ne, ishte pikërisht De Biazi.

### Revolvë kundër presidentit

#### Tifozët: Palota, shporru nga Roma



Rezultatet e dobëta që Roma ka marrë këtë fillim sezoni në kampionatin italian, kanë bërë që tifozët të harrojnë sukseset e sezonit të kaluar dhe të kërkojnë largimin e presidentit të klubit, Xhejms Palota. Njëpër qytetin e Romës, janë pikturuar grafiti të ndryshëm ku kërkohet hapur largimi i presidentit, ndërkohë që edhe shumë pankarta të ndryshme shprehin pakënaqësi ndaj drejtuesve. I prekur nga kërkesat e tifozëve, është edhe drejtori sportiv i Romës, Monki të cilin tifozët verdhekuq e

quajnë "K\*\*\* e Palotës" këtë mesjavë, Roma pret në shtëpi Frosinonen dhe

pritet që tifozët të nisin me protestat e tyre karshi drejtuesve



